

**NGA COPËZIMI NË BASHKËPUNIM
ARSIMI I LARTË, KËRKIMI DHE ZHVILLIMI
NË EVROPËN JUG-LINDORE**

nga
Toby Linden dhe Nina Arnhold
me Kirill Vasiliev

June, 2008



Nga copëzimi te bashkëpunimi
Arsimi i lartë, puna kërkimore dhe zhvillimi
në Evropën Juglindore

(From Fragmentation to Cooperation:
Tertiary Education, Research and Development
in South Eastern Europe)

Përgatitur nga:
Toby Linden, Nina Arnhold dhe Kirill Vasiliev

“Seria e punimeve për arsimin” është realizuar nga Njësia për Arsimin në Bankën Botërore (HDNED). Kjo seri ofron një model që stafi dhe konsulentët e Bankës Botërore duhet të ndjekin për të botuar dhe shpërndarë konkluzionet paraprake lidhur me arsimin me qëllim që të nxisin debatin dhe shkëmbimin e ideve brendapërbrenda Bankës Botërore, si dhe në një komunitet më të gjerë të zhvillimit. Punimet e kësaj serie nuk duhet të konsiderohen si botime zyrtare të Bankës Botërore. Konkluzionet dhe interpretimet që paraqiten në këto punime, janë konkluzione dhe interpretime të autorëve përkatës, të cilat nuk duhet t’i atribuohen në asnjë mënyrë Bankës Botërore, organizatave anëtare të saj, anëtarëve të Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë, apo vendeve që ata përfaqësojnë. Kopje të shtypura këtij botimi mund të sigurohen nëpërmjet Shërbimit Këshillimor për Arsimin (eservice@worldbank.org). Versioni elektronik i këtij botimi mund të nxirret nga faqja e internetit të Njesisë për Arsimin në Bankën Botërore (www.worldbank.org/education).

Translated from the English version into Albanian by Arben Loka

Title of English version: *From Fragmentation to Cooperation: Tertiary Education, Research and Development in South Eastern Europe*

Copyright © 2008

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore

Qershor 2008

Uashington, D.C., SHBA

Përmbajtja

| | |
|--|------------|
| Falenderime | v |
| Shkurtime | vi |
| Përmbledhje | vii |
| Gjendja aktuale | vii |
| Çfarë duhet bërë? | ix |
| Zbatimi i ndryshimit përmes bashkëpunimit rajonal | xi |
| Hyrje | 1 |
| I. Gjendja aktuale | 4 |
| II. Çfarë duhet bërë? | 23 |
| Përmirësimi i mekanizmave të financimit..... | 28 |
| Përmirësimi i cilësisë..... | 32 |
| Roli i sektorit privat të arsimit të lartë | 34 |
| Përmirësimi i kërkimit dhe zhvillimit | 36 |
| III. Zbatimi i ndryshimit nëpërmjet bashkëpunimit rajonal | 40 |
| Shtojca 1. Treguesit e axhendës së Lisbonës | 43 |
| Referenca | 45 |

Grafikët

| | |
|---|----|
| Grafiku 1. Struktura e pagave në Kroaci sipas arsimit, 1998–2002 | 5 |
| Grafiku 2a. Studentë në arsimin e lartë (ISCED 5A) në Kroaci, 1991–2004..... | 6 |
| Grafiku 3. Diplomat e arsimit të lartë në Serbi, 2000–2005 | 7 |
| Grafiku 4. Numri i të regjistruarve në arsimin e lartë në Evropën Juglindore, 2005..... | 9 |
| Grafiku 5. Klasifikimi i të regjistruarve në arsimin e lartë në | 11 |
| Grafiku 6. Shpenzime për institucione arsimore, si përqindje e PBB-së, në vende të përzgjedhura..... | 17 |
| Grafiku 7. Shpenzime të përgjithshme për kërkimin dhe zhvillimin (GERD) | 19 |
| Grafiku 8. Raporti i punonjësve shkencorë për 1.000 punonjës të forcës së punës..... | 21 |
| Grafiku 9. Shpenzime të brendshme bruto për kërkim dhe zhvillim, vende të përzgjedhura.. | 21 |
| Grafiku 10. Shpenzime për kërkim dhe zhvillim në EJK si përqindje e PBB-së, 1999–2004. | 22 |
| Grafiku 11. Sistemet e pabalancuara të arsimit të lartë: Rasti i Bosnjë-Hercegovinës..... | 26 |

Tabelat

| | |
|--|----|
| Tabela 1. Performanca e vendeve të EJL-së dhe të EQL-së | 2 |
| Tabela 2. Pagat në arsimin e lartë krahasuar me arsimin bazë, 2005 | 4 |
| Tabela 3. Studentë të huaj të regjistruar në vendet e EJL-së dhe qytetarë të vendeve të EJL-së të regjistruar jashtë vendit të tyre të origjinës | 12 |
| Tabela 4. Numri mesatar i kërkesave për patenta që paraqiten në Zyrën Evropiane të Patentave, në vit, për çdo 100.000 banorë të vendeve të EJL-së, 1997–2003 | 20 |

Kutitë

| | |
|-----------------------------------|----|
| Kutia 1: Procesi i Bolonjës | 33 |
|-----------------------------------|----|

Falenderime

Për këtë punim kanë kontribuar Toby Linden dhe Nina Arnhold, të dy specialistë të lartë për arsimin në Njësinë për Zhvillimin Njerëzor për Evropën dhe Azinë Qendrore në Bankën Botërore. Një ndihmesë të konsiderueshme për grumbullimin e të dhënave ka dhënë Kirill Vasiliev. Konsulentët Marek Këiek dhe Klaus Schuch punuan për përgatitjen e dokumentacionit përkatës. Autorët dëshirojnë t'u shprehin mirënjohjen e tyre kolegëve analistë: Jamil Salmi (kryespecialist për arsimin, Ekipi për Arsimin në Bankën Botërore), Ardo Hansson (kryeekonomist, Njësia për Uljen e Varfërisë dhe Menaxhimin Ekonomik për Evropën dhe Azinë Qendrore, Banka Botërore) dhe David Crosier (Shoqata e Universiteteve Evropiane), për kontributin që kanë dhënë me komentet e tyre. Ekipi shpreh falenderime të veçanta për komentet e vlefshme që mori lidhur me projektin përfundimtar të raportit gjatë dy takimeve konsultative, të cilat u mbajtën në muajin nëntor 2007: njëri në zyrën qendrore të Bankës Botërore, ku morën pjesë ekspertë të Bankës Botërore për arsimin e lartë; dhe tjetri në Zyrën e Bankës Botërore në Bruksel, ku ishin të ftuar Sjur Bergen (Këshilli i Evropës), David Crosier, Alojz Kralj (Universiteti i Ljubljanes), Melita Kovačević (Universiteti i Zagrebit) dhe Klaus Schuch (Qendra për Risitë Sociale, Vienë). Për redaktimin e tekstit punoi Peggy McInerney. Krahas Orsalia Kalantzopoulos dhe Jane Armitage, Drejtore të Përfaqësive, nga Banka Botërore, një kontribut thelbësor me idetë dhe aftësitë e saj drejtuese ka dhënë Drejtuesja e Sektorit e Arsimit, Mamta Murthi.

Shkurtime

| | |
|---------|---|
| CEE | Evropa Qendrore dhe Lindore (EQL) |
| ERI-SEE | Nisma për Reformën në Arsim në Evropën Juglindore (NRAEJL) |
| EU | Bashkimi Evropian (BE) |
| EUA | Shoqata e Universiteteve Evropiane (SHUE) |
| LFS | Vëzhgim i forcës së punës |
| QA | Sigurimi i cilësisë |
| RCC | Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (ish Pakti i Stabilitetit) (KBR) |
| R&D | Puna kërkimore dhe zhvillimi |
| SEE | Evropa Juglindore (EJL) |

Përmbledhje

Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Serbia gjithnjë e më tepër po vetëpërcaktohen duke u krahasuar me Bashkimin Evropian që është në zgjerim. Kjo pikë referimi ofron një këndvështrim realist, por ambicioz, lidhur me zhvillimin e tyre politik dhe ekonomik në të ardhmen. Në këtë aspekt, ato shkojnë në gjurmët e vendeve të tjera të Evropës Juglindore, d.m.th., të Bullgarisë, Rumanisë dhe Sllovenisë, të cilat tashmë janë bërë anëtare të Bashkimit Evropian. Të paturit e një ekonomie tregu konkurruese në Bashkimin Evropian, është një kusht thelbësor për të qenë anëtar i Bashkimit Evropian. Arsimi i lartë, si dhe puna kërkimore dhe zhvillimi kontribuojnë për rritjen ekonomike dhe aftësinë konkurruese duke përgatitur studentë shumë të kualifikuar, të gatshëm të marrin përsipër rolin që duhet të luajnë në një ekonomi të hapur dhe në një shoqëri demokratike, si dhe duke krijuar, transferuar dhe përshtatur njohuritë.

Ky punim ka për qëllim të bëjë analizën e gjendjes në vendet e Ballkanit, të parashtrijë drejtimet për reformën në politikat për arsimin e lartë, kërkimin dhe zhvillimin, si dhe të identifikojë alternativat lidhur me mbështetjen e Bankës Botërore për këto vende, si nëpërmjet projekteve kombëtare, ashtu edhe nëpërmjet formave të ndryshme të bashkëpunimit rajonal.

Gjendja aktuale

Në ekonominë e rajonit, individët, tashmë, shpërblehen në përputhje me nivelin e arritjeve në shkollë, dhe rezultati në tregun e punës tregon se hendeku mes atyre me arsim të lartë dhe atyre pa arsim të lartë është i konsiderueshëm. Ka të dhëna se, në kuadrin e strategjisë së tyre konkurruese, kompanitë më të suksesshme të rajonit kërkojnë punonjës të kualifikuar, sidomos me arsim të lartë.

Sidoqoftë, në vendet e Ballkanit, ofrimi i forcës së kualifikuar të punës në mënyrë që të përmbushet kjo kërkesë në rritje, shënon nivele të ulta. Numri i studentëve që braktisin arsimin e lartë është i konsiderueshëm, ndërsa numri i atyre që diplomohen është i ulët. Përveç kësaj, në këto vende, vërehet se numri i të diplomuarve me grada të avancuara në nivel master ose doktorature nuk ka ndryshuar ose ka pësuar rënie. Individë të talentuar nga këto vende, kanë më shumë gjasa se rezidentët e vendeve të tjera evropiane të lënë vendin e tyre në kërkim të mundësive diku gjetkë.

Vendet e Ballkanit hasin pengesa të mëdha ndërsa përpiqen për të rritur numrin e të diplomuarve me arsim të lartë në një periudhë afatmesme. Së pari, numri i nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm dhe, në disa vende të Evropës Juglindore, arsimin e lartë, është relativisht i ulët. Megjithatë, edhe ky numër nuk është i saktë, pasi ai fsheh numrin shumë të vogël të atyre që mbarojnë studimet universitare. Së dyti, rritja e konsiderueshme e numrit të nxënësve që regjistrohen në institucione private, në kontrast me shumë vende të Evropës Qendrore dhe Lindore, nuk e ka kompensuar numrin e ulët të të diplomuarve nga institucionet e arsimit të lartë publik. Së treti, pritet që vendet e Evropës Juglindore të pësojnë një rënie të konsiderueshme të numrit të nxënësve dhe studentëve të grup-moshave që ndjekin të gjithë fazat e arsimit.

Pra, vendet e Ballkanit përballen me probleme serioze përsa i përket cilësisë së arsimit të lartë. Ndërsa nuk ka ende të dhëna të besueshme që të shërbejnë si bazë për krahasim, studimet mbi institucionet vazhdimisht flasin për metodologji të vjetëruara të mësimdhënies dhe të zhvillimit të provimeve. Procedurat për sigurimin e cilësisë me anë të mekanizmave të brendëm dhe të jashtëm, në një masë të madhe, nuk janë efikase dhe në përputhje me zhvillimet e kohëve të fundit në Evropë.

Burimi i të gjithë këtyre problemeve është struktura institucionale e fakulteve të fuqishme dhe autonome nga pikëpamja ligjore pranë universiteteve publike. Rastet e suksesshme kur universitetet janë integruar nga pikëpamja ligjore, janë të pakta, siç është Universiteti i Tuzlës në Bosnjë-Hercegovinë. Sidoqoftë, ligjet që rregullojnë integrimin e institucioneve në vendet e Evropës Juglindore janë miratuar përgjithësisht kohët e fundit dhe ligje të tilla në këto vende nuk kanë qenë gjithmonë të efektshme.

Në krahasim me vende të tjera evropiane, shpenzimet publike për institucionet e arsimit të lartë zënë një pjesë të vogël të PBB-së. Gjithashtu, as burimet e financimit publik, as të atij privat, nuk u ofrojnë fakulteteve stimulim për të rritur efektshmërinë dhe numrin e të diplomuarve. Institucionet publike kanë mundur t'i shtojnë të ardhurat nga taksat shkollore. Sidoqoftë, kjo vetëm se ka ofruar një stimul që institucionet të vazhdojnë t'i mbajnë studentët në sistem dhe, kështu, ka ulur efektshmërinë.

Jo vetëm që sistemet e arsimit të lartë në Evropën Juglindore nuk sigurojnë numrin e kënaqshëm të të diplomuarve të kualifikuar, por studentëve që mbarojnë arsimin e lartë u mungon formimi që të kontribuojnë për aftësinë konkurruese të vendeve të tyre përkatëse, me anë të asimilimit të njohurive dhe novacionit. Përveç kësaj, kërkesa për punë kërkimore dhe zhvillim, që vjen nga kompanitë private është shumë e kufizuar. E njëjta gjë mund të thuhet

për kontributin e sistemeve ekzistuese të kërkimit dhe zhvillimit, me një numër relativisht të vogël punonjësish shkencorë dhe me shpenzime tejet të ulëta.

Çfarë duhet bërë?

Një kusht themelor që çështjet e sipërpërmendura të gjejnë zgjidhje është ristrukturimi organizativ i universiteteve publike. Përveç kësaj, sistemet e financimit publik duhet të ofrojnë stimuj që këto institucione të përmbushin misionet e tyre përkatëse për rritjen e aftësisë konkurruese dhe të kohezionit social. Realizimi i këtyre objektivave kërkon kalimin, gjithnjë e më shumë, drejt sistemeve të financimit me bazë performancën. Për shembull, subvencionet publike për taksat e universiteteve duhet të synojnë që studentët me të ardhura të pamjaftueshme, në një periudhë më afatgjatë, të lidhen me sistemet që ofrojnë kredi për studentët. Këto ndryshime kërkojnë vullnet politik nga ana e qeverive dhe përmirësimin e ndjeshëm të kapaciteteve administruese të universiteteve publike.

Sistemet e arsimit të lartë në vendet e Evropës Juglindore janë të pabalancuara. Një universitet i vetëm (zakonisht në kryeqytet) dominon gjithë sistemin përsa i përket numrit të regjistrimeve dhe burimeve. Sfidat në një periudhë afatmesme është që të krijohet një numër i kënaqshëm universitetesh efektive dhe me programe të plota mësimore. Në një periudhë më afatgjatë, duhet të krijohen sisteme të arsimit të lartë, që të jenë më të balancuara dhe që përmbushin nevojat e ndryshme (përfshirë nevojat e ndryshme rajonale), si dhe përmirësimin e sektorit politeknik dhe specializimin e institucioneve të arsimit të lartë.

Pjesëmarrja e vendeve të veçanta në Procesin e Bolonjës, i cili synon të bëjë ekuivalentimin e diplomave të arsimit të lartë në mbarë Evropën, si dhe të nxisë lëvizjen,¹ u jep atyre një mundësi të madhe që të përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënësit në universitete, një mundësi kjo, që ende nuk është shfrytëzuar në mënyrë të kënaqshme. Vëmendje shumë e madhe i është kushtuar ndryshimeve burokratike brendapërbrenda universiteteve, ndërsa ka munguar vëmendja e duhur për rihartimin e programeve mësimore dhe modernizimin e praktikës së mësimdhënies. Në çdo vend të rajonit, duhet t'i kushtohet vëmendje urgjente gjithashtu sistemit të sigurimit të cilësisë me qëllim që të vendoset ekuilibri i duhur mes llogaridhënies dhe autonomisë.

¹ Procesi i Bolonjës është një proces gjithëpërfshirës i reformës në arsimin e lartë në Evropë, ku, aktualisht, janë përfshirë 46 vende. Procesi i Bolonjës synon, mes të tjerash, krijimin e një strukture me tre cikle kualifikuese (d.m.th., diplomë, nivel master dhe doktoraturë), ekuivalentimin e diplomave dhe mundësinë e lëvizjes së akademikëve. Shih faqen e internetit të Procesit të Bolonjës, <http://www.ond.vlaanderen.be/hogeronderwijs/bologna/about> (vizituar në maj 2008).

Nuk ka ndonjë recetë të caktuar përse i përket rolit të institucioneve private. Ndoshta, sektori privat do ta japë kontributin më të madh duke nxitur larminë e institucioneve të arsimit të lartë. Ky rezultat kërkon që sistemet kombëtare të sigurimit të cilësisë dhe, veçanërisht, të akreditimit të mbështesin larminë institucionale. Sidoqoftë, gjatë krijimit të këtyre sistemeve, qeveritë duhet të zgjidhin problemin që ka të bëjë me faktin se shumica e stafit mësimdhënës në institucionet private kanë kontrata me institucionet publike.

Gjatë përmirësimit të sistemeve të tyre të kërkimit dhe zhvillimit, vendet e Evropës Juglindore përballen me sfida të shumëfishta, megjithatë themelet për efektshmërinë e tyre, në një periudhë afatgjatë, duhen hedhur tani. Në një periudhë afatshkurtër, theksi duhet vënë më shumë te përshtatja e njohurive ekzistuese sesa te novacioni dhe krijimi i njohurive të reja. Për të arritur këtë objektiv fillestar, forcimi i lidhjeve mes universiteteve publike dhe sipërmarrjeve private duhet të përbëjë prioritetin të rëndësishëm përse i përket kërkimit dhe zhvillimit, duke patur parasysh se kontributi më i madh që mund t'i japë një sektor kërkimor vendit është që të ndihmojë kompanitë të përvetësojnë dhe të përshtasin ide dhe teknologji të reja nga vende të tjera. Njëkohësisht, duhet të rriten në mënyrë të konsiderueshme financimet private për nevojat e kërkimit dhe zhvillimit, si dhe punësimi i punonjësve shkencorë në sektorin privat. Së fundi, financimi publik për kërkimin dhe zhvillimin duhet të planifikohet me efektshmëri më të madhe, mundësisht, përmes bashkëpunimeve privat-publik. Fatmirësisht, shumë vende në mbarë botën kanë përvojë të suksesshme në zbatimin e bashkëpunimeve të tilla publik-privat, të cilat marrin një larmi formash.

Përqendrimi në një periudhë afatshkurtër te kërkimi i aplikuar ndihmon për ta përmirësuar në një periudhë afatgjatë kërkimin bazë. Sidoqoftë, që financimi publik t'i japë kërkimit bazë më pak prioritet nga ç'i jep aktualisht, nevojiten qasje të reja lidhur me emërimin dhe promovimin e personelit akademik të universiteteve. Në të ardhmen e parashikueshme, përse i përket kërkimit, secili nga vendet e Evropës Juglindore do të arrijë të shkëlqejë në më shumë fusha specifike, kështu që përcaktimi i fushave që justifikojnë investimet do të jetë një sfidë e madhe për qeveritë. Qeveritë kanë dy mënyra sesi të shpërndajnë riskun e investimeve dhe të rritin mundësitë për sa i përket kërkimit dhe zhvillimit: të përfshijnë në këto vendime sektorin privat, meqënëse ky sektor ka më shumë mundësi që të përcaktojë fushat që i shtojnë vlerë veprimtarive të tij; ose të bashkëpunojnë me vende dhe institucione të tjera që të ndajnë burimet (p.sh.: njerëzit, pajisjet dhe idetë). Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar mbështetjes në të ardhmen të punonjësve shkencorë, studiuesve të rinj dhe të statusit të tyre brenda sistemit të kërkimit dhe zhvillimit.

Zbatimi i ndryshimit përmes bashkëpunimit rajonal

Realizimi i programit të reformës që parashtrohet më sipër, kërkon kohë dhe burime të tjera të konsiderueshme, gjë që kërkon një strategji të qartë për realizimin e tij në praktikë, si dhe ndarjen e shpenzimeve përmes bashkëpunimit rajonal. Në bashkëpunim me aktorë të tjerë rajonalë, Banka Botërore mund të luajë rol për nxitjen e këtij programi të reformës. Kusht paraprak për bashkëpunimin rajonal është se ai duhet të jetë sa më i thjeshtë dhe i përqendruar që të jetë e mundur, gjë që do të thotë se numri i veprimtarive të llojeve të ndryshme dhe puna që synohet të bëhet në çdo veprimtari, duhet të kufizohen në mënyrë rigoroze. Sigurisht, një vullnet i tillë mund të shprehet vetëm nëpërmjet dialogut me vendet e interesuara. Sidoqoftë, mbështetur në përvojën e saj, Banka Botërore bën parashikime lidhur me mënyrën sesi duhet të ndikojë te operacionet e huadhënies me qëllim që, në sistemet universitare, të realizohen ndryshime të rëndësishme.

Banka mund të propozojë dy lloje veprimtarish, të cilat përkrijnë me dy lloje të ndryshme bashkëpunimi mes vendeve të Evropës Juglindore. Në thelb, veprimtaritë e bashkërenduara kanë karakter kombëtar, por ato trajtojnë çështje, me të cilat përballen të gjitha vendet e rajonit dhe, për këtë arsye, mund të trajtohen në mënyrë bashkëpunuese, ku shumë vende punojnë bashkarisht dhe mësojnë nga njëri-tjetri. Për të qenë të efektshme, veprimtaritë e integruara *kërkojnë* qasje rajonale dhe mund të realizohen nga vendet e rajonit në bashkëpunim të plotë me njëri-tjetrin.

Banka Botërore synon të përdorë këtë punim analitik si bazë për ta diskutuar këtë temë me vendet e Evropës Juglindore. Gjatë diskutimeve të tilla do të kërkohet të bëhet verifikimi i fakteve dhe i argumenteve që do të paraqiten, dhe do të përcaktohen mënyra për t'u ofruar vendeve asistencë në mënyrë që të përshpejtojnë reformën në arsimin e lartë, si dhe kërkimin dhe zhvillimin.

Hyrje

Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, ish-Republika Jugoslave e Maqedonisë dhe Serbia (d.m.th., të gjitha vende të Evropës Juglindore) gjithnjë e më tepër po vetëpërcaktohen duke u krahasuar me Bashkimin Evropian **që është në zgjerim. Kjo pikë referimi ofron një këndvështrim realist, por ambicioz, lidhur me zhvillimin e tyre politik dhe ekonomik në të ardhmen.** Në këtë aspekt, ato shkojnë në gjurmët e vendeve të tjera të Evropës Juglindore, d.m.th., të Bullgarisë, Rumanisë dhe Sllovenisë, të cilat tashmë janë bërë anëtare të Bashkimit Evropian. Axhenda e Lisbonës, me anë të së cilës vendet e Bashkimit Evropian synojnë të bëhen rajoni më konkurrues i botës, ofron gjithashtu kuadrin për zhvillimin ekonomik të të gjithë vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Të paturit e një ekonomie tregu, që të jetë konkurruese brendapërbrenda BE-së, është një kusht thelbësor për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.² Sidoqoftë, në shumë aspekte, ekonomitë e vendeve të Evropës Juglindore nuk kanë arritje të kënaqshme. Bashkimi Evropian ka përcaktuar 16 tregues, përfshirë pesë standarde, me anë të të cilave do të monitorojë kontributin e arsimit dhe kualifikimit në realizimin e Axhendës së Lisbonës (shih Shtojcën 1). Fatkeqësisht, për qëllimet e këtij studimi, treguesit për arsimin e lartë janë të paktë në numër dhe për shumë vende të Evropës Juglindore nuk ka të dhëna të krahasueshme. Një mjet më i vlefshëm për krahasimin e vendeve është “Raporti për aftësinë e konkurrencës në botë” i Forumit Botëror Ekonomik (WEF). Nga 131 vendet që klasifikohen për vitin 2007, Sllovenia dhe Kroacia ishin vendet më të suksesshme të Evropës Juglindore, të renditura, përkatësisht, në vendin e 39-të dhe 57-të, ndërsa vendet e tjera të Evropës Juglindore ishin më poshtë se vendi i 70-të (WEF 2007, tabela 1).

² Kriteret e Kopenhagenit përcaktojnë parimet që duhet të ndjekin vendet për t’u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Testi ekonomik ka të bëjë me “ekzistencën e një ekonomie funksionale të tregut dhe aftësinë për t’u përballur me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brendapërbrenda Bashkimit”. Kriteri politik ka të bëjë me “stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, si dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave”. Së fundi, vendet duhet të pranojnë edhe *acquis communautaire* të Komunitetit (aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, përfshirë realizimin e qëllimeve të bashkimit politik, ekonomik dhe monetar). Këshilli Evropian, Kopenhagen, 21-22 qershor 1993. Konkluzionet e Presidencës, 22 qershor 1993.

**Tabela 1. Performanca e vendeve të EJL-së dhe të EQL-së
Raporti për aftësinë konkurruese në botë 2007—2008 (N=131)**

| <i>Vendi</i> | <i>Renditja e përgjithshme</i> | <i>Renditja e arsimit të lartë dhe trainimit</i> | <i>Renditja e novacionit</i> |
|--------------------|--------------------------------|--|------------------------------|
| Shqipëria | 109 | 103 | 131 |
| Bosnjë-Hercegovina | 106 | 98 | 121 |
| Kroacia | 57 | 46 | 50 |
| Maqedonia, IRF | 94 | 75 | 92 |
| Mali i Zi | 82 | 79 | 104 |
| Serbia | 91 | 82 | 78 |
| Bullgaria | 79 | 66 | 88 |
| Rumania | 74 | 54 | 76 |
| Sllovenia | 39 | 24 | 30 |

Burimi: WEF (2007).

Krijimi i një ekonomie konkurruese, e një ekonomike që është në zhvillim dhe krijon vende pune të orientuara në drejtim të së ardhmes, kërkon masa politike në shumë sektorë, përfshirë arsimin, dhe veçanërisht arsimin e lartë. Studimet që ka bërë Banka Botërore që në fillim të viteve '90-të, tregojnë se zhvillimi i arsimit të lartë lidhet me zhvillimin ekonomik (Banka Botërore, 1994). Këto konkluzione janë përforcuar nga studimet më të fundit për ndërtimin e shoqërive të dijeve. Këto studime tregojnë se aftësia e një shoqërie për të prodhuar, përzgjedhur, përshtatur, tregtuar dhe për të përdorur dijet është shumë e rëndësishme për rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe përmirësimin e standardeve të jetesës. Pra, theksohet fakti se dijet janë bërë faktori më i rëndësishëm në rritjen ekonomike (Banka Botërore, 2002; Yusuf dhe Nabeshima, 2007). Është provuar se kapitali njerëzor në arsimin e përgjithshëm, por, sidomos, në arsimin e lartë, është me rëndësi vendimtare për të mbështetur novacionin dhe aftësinë konkurruese.

Arsimi i lartë, kërkimi dhe zhvillimi kontribuojnë për rritjen ekonomike në mënyra të ndryshme. Së pari, arsimi i lartë u siguron ekonomive njerëz të diplomuar. Së dyti, arsimi i lartë krijon dije të reja nëpërmjet kërkimit dhe novacionit, dhe së fundi, arsimi kontribuon për transferimin dhe asimilimin e dijeve ekzistuese, gjë që ka rëndësi të veçantë për vendet e Evropës Juglindore.

Përveç kësaj, arsimi i lartë mund të luajë rol shumë të rëndësishëm në krijimin e shoqërive moderne dhe demokratike. Një numër aftësish dhe dijesh që duhet të kenë të

diplomuarit për të qenë të suksesshëm në tregun e punës, siç janë analiza, gjykimi kritik dhe shprehitë e mira të komunikimit, janë gjithashtu të nevojshme për qytetarinë demokratike. Arsimi i lartë mund të transmetojë vlerat, mbi të cilat ndërtohen shoqëritë demokratike.

Ky punim ka si objektiv që të parashtojë drejtimet e reformës së politikave në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në vendet e Ballkanit dhe të përcaktojë mënyrat, në të cilat Banka Botërore mund t'i ndihmojë këto vende që të realizojnë programin e reformës, veçanërisht, nëpërmjet bashkëpunimit rajonal. Pjesa I trajton performancën e arsimit të lartë dhe të sistemeve të kërkimit shkencor në rajonin e Evropës Juglindore dhe në ç'masë i ndihmojnë ato vendet dhe individët për t'u bërë më konkurrues. Pjesa II trajton disa drejtime kryesore të politikave, të cilat vendet në fjalë mund t'i marrin në shqyrtim që t'i ndjekin, në bazë të përvojës ndërkombëtare. Pjesa III analizon alternativat sesi Banka Botërore mund t'i mbështesë këto ndryshime në vendet e Evropës Juglindore nëpërmjet bashkëpunimit rajonal.

I. Gjendja aktuale

Në ekonomitë e Evropës Juglindore, individët tashmë shpërblehen në përputhje me nivelin e arritjeve në shkollë. Rezultati në tregun e punës tregon se hendeku që ekziston mes atyre me arsim të lartë dhe atyre pa arsim të lartë është i kosiderueshëm. Për shembull, individët me diploma të arsimit të lartë kanë rroga, të paktën, 50 % më të larta sesa punonjësit që kanë vetëm arsim bazë (ky diferencë është më e ulët në Bosnjë-Hercegovinë, por gjithsesi një 35 % i pranueshëm) dhe të paktën 38 % më të larta sesa punonjësit me arsim të mesëm (përsëri, Bosnja vijon me 25 %). (Shih tabelën 2 dhe grafikun 1 më poshtë).³ Gjithashtu, të diplomuarit me arsim të lartë marrin pjesë në tregun e punës në nivele shumë më të larta sesa individët me arsim më të ulët dhe, në rastet kur punësohen, kanë ndjeshëm më shumë gjasa të punojnë në sektorin formal, ku perspektiva e vendit të punës është më e sigurtë dhe individët kanë më shumë gjasa të gjejnë mundësi të mëtejshme për arsim dhe kualifikim (Betcherman et al., 2007). Këto konkluzione përputhen me faktet që ekzistojnë për vendet në mbarë botën.⁴

Tabela 2. Pagat në arsimin e lartë krahasuar me arsimin bazë, 2005

| | <i>Shqipëria</i> | <i>Bosnjë- Hercegovina</i> | <i>Maqedonia</i> | <i>Serbia</i> |
|---|------------------|--------------------------------|------------------|---------------|
| <i>Të gjithë njerëzit në moshë pune</i> | | | | |
| 1–3 vjet shkollë e mesme | 19.2 | -1.2 | 5.3 | 13.3 |
| 4–5 vjet shkollë e mesme | 11.5 | 7.4 | 19.2 | 31.0 |
| Arsim pas shkollës së mesme | 62.2 | 32.6 | 57.4 | 70.5 |
| <i>Të rinj (më pak se 35 vjeç)</i> | | | | |
| 1–3 vjet shkollë e mesme | 15.9 | -1.3 | -4.1 | 12.7 |
| 4–5 vjet shkollë e mesme | 21.2 | 9.9 | 7.6 | 27.6 |
| Arsim pas shkollës së mesme | 70.2 | 45.6 | 49.2 | 66.1 |

Burimi: Betcherman et al., 2007.


Shënime: 1. Të dhënat për Bosnjën janë të vitit 2004.

2. Për Shqipërinë dhe Bosnjën, shifrat i referohen më shumë arsimit të mesëm profesional, krahasuar me arsimin e mesëm të përgjithshëm, sesa kohëzgjatjes së ndryshme të programeve të arsimit të mesëm.

3. Megjithëse Kroacia nuk përfshihet në këtë tabelë, në këtë vend, punonjësit me 2 vjet arsim pas shkollës së mesme dhe ata me arsim universitar apo pasuniversitar, kanë paga, përkatësisht, 91.2 % dhe 132.8 % më të larta (Banka Botërore, 2007b).

⁴ Për rezultatet e përgjithshme të tregut të punës në vendet e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore, shih Rutkowski dhe Scarpetta (2005); për nivelet e kthimit në shkallë botërore, shih Patrinos et al. (2006).

Grafiku 1. Struktura e pagave në Kroaci sipas arsimit, 1998–2002




Burimi: Republika e Kroacisë (2007).

Ka tregues se, në kuadrin e strategjisë së tyre konkurruese, kompanitë më të suksesshme të rajonit kërkojnë punonjës me kualifikim të lartë, sidomos me arsim të lartë. Kualifikimi dhe arsimimi i punonjësve nuk përcaktohet si kufizimi më i madh ekonomik i kompanive në vendet e Evropës Juglindore, por rreth 25 % e subjekteve i përcaktojnë ato si problematike për veprimtaritë dhe zhvillimin e tyre (krahasuar, për shembull, me politikat rregullatore, të cilat identifikuan si problematike 60 % të subjekteve). Në Shqipëri, subjektet (rreth një e treta) kishin paksa më shumë gjasa sesa vendet e tjera të Evropës Juglindore ta vinin theksin te kufizimi për shkak të kualifikimit. Janë pikërisht subjektet më dinamike dhe konkurruese, ato që shprehen më rëndom lidhur me kufizimet për shkak të kualifikimit. Gjithashtu, kompanitë e mesme (50–249 punonjës), ato që operojnë në sektorë më dinamikë, ato që kanë rritje të shitjeve dhe eksporteve, subjektet e reja (me përvojë më pak se dhjetëvjeçare), si dhe ato që kanë investuar në kërkim dhe zhvillim, e nënvizojnë këtë kufizim më shumë sesa subjektet e tjera (Betcherman et al., 2007).

Sidoqoftë, në vendet e Evropës Juglindore, ofrimi i forcës së kualifikuar të punës me arsim të lartë në mënyrë që të përmbushet kjo kërkesë në rritje, shënon nivele të ulta. Numri i i lartë i studentëve që braktisin arsimin e lartë dhe numri i ulët i atyre që diplomohen, pasqyrojnë nivelet e ulëta të efektshmërisë së arsimit të lartë. (shih grafikët 2a dhe 2b). Përveç

kësaj, në vendet e rajonit, vërehet se numri i të diplomuarve me nivel master ose doktorature nuk ka ndryshuar ose ka pësuar rënie (shih grafikun 3). Ky problem ka gjasa të vazhdojë në qoftë se nuk ndërmerren veprime të efektshme shtrënguese për shkak të rënies së numrit të të rinjve. Njëkohësisht, diploma e universitetit nuk është përcaktuar përfundimisht si diplomë në vetvete, e vlefshme në tregun e punës.


Grafiku 2a. Studentë në arsimin e lartë (ISCED 5A) në Kroaci, 1991–2004



Burimi: Republika e Kroacisë (2007).

Shënim: Studentët e vitit të parë, në një vit të dhënë, pritet që të diplomohen pas 5 vjetësh.


Grafiku 2b. Studentë në arsimin e lartë në Serbi, 1990–2005



Burimi: Shërbimi Serb i Statistikave, <http://webrzs.statserb.sr.gov.yu> (vizituar në janar 2008)

Shënim: Studentët e vitit të parë, në një vit të dhënë, pritet që të diplomohen pas 5 vjetësh

Grafiku 3. Diplomat e arsimit të lartë në Serbi, 2000–2005



Burimi: Shërbimi Serb i Statistikave, <http://webrzs.statserb.sr.gov.yu> (vizituar në janar 2008)

Numri i personave me kualifikim të lartë në rajon është i pakënaqshëm. Në grupin e të rinjve nën moshën 35 vjeç, të cilët, përgjithësisht, kanë kualifikim të lartë, numri i atyre me diplomë të arsimit të lartë shkon nga vetëm 6 % në Bosnjë-Hercegovinë, në 20 % në Malin e Zi (Betcherman et al., 2007). Në raport me numrin e përgjithshëm të të rriturve të çdo vendi, kjo


përqindje është akoma më e ulët. Në Kroaci, në vitin 2001, 11.4 % e popullsisë kishte diplomë të arsimit të lartë (Adamović dhe Mežnarić, 2003). Për Bullgarinë, Rumaninë dhe Slloveninë nuk ka të dhëna krejtësisht të krahasueshme, por grupet e të arsimuarve me shkollë të lartë në këto vende klasifikohen, përkatësisht, në 99 %, 48 % dhe 87 % të mesatares së rezidentëve me arsim të lartë në Bashkimin Evropian (21.2 %) (EC, 2006). Ndërsa ky është lajm i mirë për njerëzit me arsim të lartë, të cilët mund të presin rritje të të ardhurave, nuk është lajm i mirë për ekonomitë e tyre kombëtare. Të dhënat nga vendet e OECD tregojnë se, me gjithë shifrat në rritje të të diplomuarve me arsim të lartë, të ardhurat për këtë nivel arsimi vazhdojnë të rriten (OECD, 2007).

Individë të talentuar nga vendet e Evropës Juglindore kanë më shumë gjasa të lënë vendin e tyre, në kërkim të mundësive diku gjetkë. Ndërsa ky është një problem, me të cilin përballen pothuajse të gjitha vendet, në këtë klasifikim, vendet e Ballkanit, në shkallë botërore, renditen nga vendi i 110-të e *poshtë* (dy përjashtimet janë Kroacia që renditet e 67-ta, dhe Sllovenia që renditet e 37-ta) (WEF, 2007). Duket se ka gjasa që reformat, të cilat synojnë të rrisin lëvizjen në Evropë, siç janë ato që ndërmerren në kuadrin e Procesit të Bolonjës, krahas reformave më të përgjithshme për vizat, do ta përkeqësojnë këtë problem. Përsëri, ndërsa lëvizja është e mirë për individët, ajo do të jetë e mirë për vendet ofruese vetëm nëse ato do të arrijnë të përfitojnë nëpërmjet të personave që kthehen, dërgesave të parave apo dijeve. Megjithatë, në qoftë se një numër i konsiderueshëm individësh synojnë të kthehen në vendet e tyre të origjinës, nevojitet një infrastrukturë ekonomike dhe kërkimi, të cilën vendet e Evropës Juglindore ende nuk e kanë. Është fakt i njohur, për shembull, që Irlanda arriti të ndryshojë drejtimin e emigracionit masiv jashtë vendit, që vazhdoi për dhjetra vjet, duke përdorur një strategji kombëtare, e cila vinte në qendër investimet e përgjithshme për kapitalin njerëzor.

Vendet e Evropës Juglindore hasin pengesa të mëdha në përpjekjet për të rritur numrin e të diplomuarve me arsim të lartë në një periudhë afatmesme. Së pari, numri i nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm dhe, në disa vende, edhe arsimin e lartë, është relativisht i ulët. Shifrat e fundit për regjistrimet në arsimin e lartë, në ato vende të Evropës Juglindore, të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian, tregojnë se ato janë 15 ose më shumë pikë pas vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore. Për shembull, në Rumani dhe Bullgari, numri i të regjistruarve në arsimin e lartë është, përkatësisht, 40 % dhe 43 %. Sidoqoftë, Kroacia përbën përjashtim, me një shifër të përgjithshme prej 36 % (shih grafikun 4). Këto përqindje janë rritur ndjeshëm gjatë

pesë viteve të fundit, por janë rritur edhe përqindjet e vendeve të tjera. Gjithashtu, numri i përgjithshëm i të regjistruarve në arsimin e mesëm për Bosnjën (45.0 %) dhe Shqipërinë (58.7 %) është dukshëm më i ulët sesa nivelet e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore (të gjitha ato kanë nivele regjistrimi mbi 92 %). Me 86.1 %, Kroacia është shumë afër mesatares së vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore; Maqedonia, me 73.4 %, është në mes (UNICEF, 2007). Për Serbinë, aktualisht, nuk ka të dhëna të besueshme, por, në vitin 2001, ajo kishte një përqindje që i afrohej asaj të Bosnjës (d.m.th., më pak se 50 %).

Grafiku 4. Numri i të regjistruarve në arsimin e lartë në Evropën Juglindore, 2005



Megjithatë, numri i të regjistruarve në arsimin e mesëm dhe të lartë nuk jep një tablo të saktë të të diplomuarve që ofrohen në tregun e punës, për shkak të numrit të lartë që braktisin studimet universitare, si dhe numrit shumë të ulët të atyre që mbarojnë studimet universitare. Faktet tregojnë se, në disa nga vendet e Evropës Juglindore, numri i atyre që kalojnë nga arsimi i mesëm në arsimin e lartë, është shumë i lartë. Për shembull, thuhet se, në Malin e Zi, 70 % e popullsisë në moshë shkollore ndjek arsimin e lartë; shifrat më të fundit nga Maqedonia tregojnë se mbi 60 % e atyre që përfundojnë ciklin e lartë të arsimit të mesëm, ndjekin arsimin e lartë.⁵ Sidoqoftë, numri i individëve me diplomë universitare vazhdon të mbetet i ulët. Për shembull, në Serbi, më pak se 20 % e studentëve i përfundojnë studimet në

⁵ Korrespondencë private e rektorëve të universiteteve me autorë, tetor 2007.


kohën e duhur⁶, ndërsa, në Kroaci, ky numër arrin vetëm në 10–15 % (Republika e Kroacisë, 2007). Këto përqindje shkojnë paralelisht me numrin e atyre që braktisin studimet, numër ky që është ndjeshëm më i lartë sesa mesatarja prej 30 % e OECD-së (OECD, 2007). Për të zgjidhur çështjen e numrit të atyre që kalojnë në arsimin e lartë, politikëbërësit, gjithashtu, duhet të zgjidhin çështjen e ofrimit të arsimit të mesëm, krahas strukturës së përgjithshme dhe drejtimeve të sistemeve të tyre arsimore.

Në Evropën Juglindore, rritja e konsiderueshme e numrit të nxënësve që regjistrohen në institucione private, nuk e ka kompensuar numrin e ulët të të diplomuarve nga institucionet e arsimit të lartë publik. Vendet e Evropës Juglindore ndahen në dy kategori (shih grafikët 4 dhe 5): vende që kanë qenë të hapura ndaj numrit në rritje të regjistrimeve në sektorin privat dhe vende që nuk kanë qenë të hapura. Në kategorinë e parë, numri i të regjistruarve në Maqedoni u rrit me shpejtësi pas legalizimit të arsimit të lartë privat dhe duket se ka gjasa të rritet më tej. Gjatë pesë viteve të fundit, mundësia e shqiptarëve etnikë për të ndjekur arsimin e lartë, nëpërmjet Universitetit të Tetovës, është rritur aq ndjeshëm në Maqedoni sa që, praktikisht, të gjithë shqiptarët etnikë në vend, të cilët përfundojnë arsimin e mesëm, mund të pranohen tani. Ndonëse, në Shqipëri, numri i përgjithshëm i të regjistruarve në arsimin e lartë është ende shumë i ulët, edhe ajo, teorikisht, përfshihet në këtë kategori, bashkë me Bullgarinë dhe Rumaninë. Vendet që përfshihen në kategorinë e dytë, ku arsimi i lartë privat nuk është kaq i mirëpritur, siç janë Bosnja dhe Kroacia, duket (në bazë të tendencave të numrit të të regjistruarve) se paraqesin më shumë rezistencë ndaj shtrirjes së arsimit të lartë privat dhe, në një periudhë më afatgjatë, kanë gjasa të kenë një numër shumë më të vogël të të regjistruarve (më afër shifrave që jepen për Slloveninë). Nuk është e qartë pse numri i të regjistruarve ndryshon kaq shumë mes vendeve të këtyre dy grupeve. Kuadri ligjor dhe rregullator në to duket se është i ngjashëm, po ashtu edhe konkurrenca e studentëve në institucionet publike që paguajnë taksa.⁷ Vështirësitë, me të cilat përballen Bosnja dhe Kroacia, lidhen kryesisht me nevojën që kanë për t'u barazuar në drejtim të numrit të përgjithshëm të të regjistruarve në arsimin e lartë, që është edhe pika ku ato ndryshojnë shumë nga Sllovenia. Shifrat e fundit tregojnë se, në Slloveni, për çdo 100.000 banorë ka 5.618 studentë të regjistruar; shifrat përkatëse për Bosnjën dhe Kroacinë janë, përkatësisht, 2.166 dhe 3.632 (Qendra Evropiane për Arsimin e Lartë, 2007).

⁶ Shërbimi Serb i Statistikave.

⁷ Ky problem meriton studim të mëtejshëm, por ai, fatkeqësisht, ishte jashtë objektit të këtij raporti.

Grafiku 5. Klasifikimi i të regjistruarve në arsimin e lartë në Evropën Qendrore dhe Lindore, 2004–2005



Burimi: Qendra Evropiane për Arsimin e lartë (2007), përveç IRF të Maqedonisë (shifrat u janë dhënë autorëve nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, nëntor 2007).

Gjithashtu, vendet e Evropës Juglindore përballen me një rënie të konsiderueshme të grup-moshave që ndjekin të gjitha fazat e arsimit, tendencë kjo që ka gjasa të çojë në uljen e mëtejshme të numrit të të diplomuarve me arsim të lartë, të cilët do të hyjnë në të ardhmen në tregun e punës. Në të gjitha vendet e Evropës Juglindore, parashikohet që, deri në vitin 2025, numri i të rinjve, të cilët ndjekin arsimin e lartë për herë të parë, të bjerë më shumë se 30 % (sidoqoftë, në Shqipëri dhe Serbi, ky numër pritet të jetë, përkatësisht, 15 % dhe 26 %) (Banka Botërore, 2007). Bullgaria dhe Rumania përballen me ulje më të ndjeshme të këtij numri. Duke e marrë të mirëqenë se të gjithë faktorët e tjerë nuk do të pësonin ndryshime, zvogëlimi i madhësisë së grup-moshave do të mundësonte rritjen e numrit të të regjistruarve pa shtuar burimet. Gjithashtu, kjo do të thotë se shifrat absolute të të diplomuarve do të kenë rënie në qoftë se këto vende nuk do të arrijnë të rritin numrin e atyre që kalojnë në arsimin e lartë dhe që përfundojnë arsimin e lartë. Në Bullgari, vërehet tashmë një rënie e shifrave absolute të studentëve që ndjekin arsimin e lartë (Banka Botërore, 2007a). Përveç kësaj, në të ardhmen,

këtyre vendeve do t'u duhet të ofrojnë mundësi më të mëdha për ata që janë tashmë në tregun e punë, me qëllim që të vazhdojnë arsimimin dhe kualifikimin e tyre.

Përtej çështjes së numrit të studentëve, vendet e Ballkanit përballen me probleme serioze që kanë të bëjnë me cilësinë e arsimit të lartë. Ndërsa nuk ka të dhëna të besueshme, që të shërbejnë si bazë për krahasim, studimet mbi institucionet e arsimit të lartë në Evropën Juglindore, vazhdimisht, flasin për mbizotërimin e metodologjive të vjetëruara të mësimdhënies dhe të zhvillimit të provimeve, të cilat testojnë të mësuarit përmendësh dhe riprodhimin e fakteve (shih, për shembull, SHUE, 2003). Kjo është arsyeja që një numër i lartë studentësh nga rajoni e përsërisin dhe e braktisin shkollën e lartë.

Një tregues tjetër i cilësisë së arsimit është nëse në një vend regjistrohen studentë nga vende të tjera. Sidoqoftë, pavarësisht nga e drejta e akademikëve për të lëvizur, është gjithashtu interesante të vërehet nëse studentët e një vendi të caktuar inkurajohen që t'i ndjekin studimet universitare në vendin e tyre për shkak të cilësisë së institucioneve vendase. Tabela 3 tregon se të gjitha vendet e Evropës Juglindore shënojnë shifra të ulëta të regjistrimit të studentëve të huaj, dhe dërgojnë një pjesë të madhe të studentëve të tyre në vende të tjera. Gjithashtu, duhet vënë në dukje se shumica e studentëve të huaj, që studiojnë në vendet e Evropës Juglindore, janë nga vendet fqinje, për shembull: në Kroaci, studentët nga Bosnjë-Hercegovina, Sllovenia, Serbia dhe Mali i Zi përbëjnë rreth 59 % të studentëve të huaj.

Tabela 3. Studentë të huaj të regjistruar në vendet e EJL-së dhe qytetarë të vendeve të EJL-së të regjistruar jashtë vendit të tyre të origjinës

| | <i>Studentë të huaj në arsimin e lartë, si % e të gjithë studentëve në arsimin e lartë</i> | | | <i>Përqindja e të gjithë studentëve në arsimin e lartë (Nivelet 5 dhe 6 të ISCED-së) të regjistruar jashtë vendit të tyre të origjinës</i> | | |
|------------------|--|------|------|--|------|------|
| | 2000 | 2003 | 2004 | 2000 | 2004 | 2005 |
| Bullgaria | 3.11 | 3.48 | 3.63 | 3.2 | 8.6 | 8.7 |
| Kroacia | -- | 0.55 | 0.63 | -- | 6.9 | 6.3 |
| IRF e Maqedonisë | 0.66 | 0.25 | 0.33 | 6.2 | 10.4 | 12.1 |
| Rumania | 2.78 | 1.51 | 1.53 | 1.5 | 2.4 | 2.3 |
| Sllovenia | 0.93 | 1.05 | 1.06 | 2.2 | 2.1 | 2.0 |
| BE 27 | 4.95 | 6.16 | 6.32 | 2.1 | 2.2 | 2.2 |

Burimi: EC (2007).

Rritja e shpejtë e numrit të institucioneve private në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, si kudo në botë, u shoqërua me shqetësime lidhur me cilësinë e tyre. Shpeshherë, këto shqetësime kanë nxitur përfshirjen e mekanizmave të sigurimit të cilësisë dhe të akreditimit. Sidoqoftë, mungesa e të dhënave dhe mekanizmave të besueshëm për vlerësimin e cilësisë e bën të pamundur që të nxirren konkluzione të vlefshme, duke marrë parasysh interpretimet e shumëfishta të të dhënave që ekzistojnë. Për shembull, si pasojë e ndryshimit të politikave në Gjeorgji, në vitin 2003, gjë që çoi në zbatimin rigoroz të rezultateve të akreditimit, 110 nga 227 institucionet arsimore nuk u lejuan që të pranonin regjistrimin e studentëve të rinj për vitin pasardhës akademik (Pachuashvili, 2007). Ndërsa tregon se 110 institucionet kishin cilësi të dobët, ky rezultat, gjithashtu, konfirmon se 117 institucione private ishin të vendosura të ruanin një cilësi (të paktën) të pranueshme.

Në Evropën Juglindore, procedurat për sigurimin e cilësisë brenda dhe jashtë institucioneve arsimore, në një masë të madhe, nuk janë efikase dhe në përputhje me zhvillimet e kohëve të fundit në Evropë. Sigurimi i cilësisë nga jashtë institucioneve arsimore, i cili lidhet me njohjen e diplomave dhe programeve, u bë si kërkesë e Procesit të Bolonjës në Bashkimin Evropian, ashtu edhe domosdoshmëri, duke patur parasysh shtrirjen e arsimit të lartë, sidomos në sektorin privat. Në përgjigje të kësaj, për sigurimin e cilësisë, vendet e rajonit të Evropës Juglindore, shpeshherë, krijuan mekanizma të ngurtë të jashtëm, të cilët përqendroheshin te vlerësimi dhe akreditimi i institucioneve, si dhe te vlerësimi dhe akreditimi i programeve të veçanta. Sidoqoftë, këto mekanizma nuk çuan në institucione të cilësisë së lartë. Përkundrazi, si rezultat u krijuan organe shumë burokratike të sigurimit të cilësisë, të cilat nuk u mbështetën në mënyrë efikase te komuniteti evropian dhe ndërkombëtar i sigurimit të cilësisë.

Ndaj sigurimit të cilësisë, mbahen qëndrime të ndryshme, që ndryshojnë, veçanërisht, mes Shteteve të Bashkuara dhe vendeve të Evropës (qëndrimet e të cilave mund të ndryshojnë nga njëri-tjetri). Ndërsa disa vende, dikur, e drejtonin vëmendjen te akreditimi në nivelin e programit (p.sh.: Gjermania, ku zhvillohet një diskutim i vazhdueshëm për probleme që lidhen me këtë qasje, përfshirë procedurat tejet burokratike), vende të tjera kanë kaluar drejt akreditimeve institucionale (p.sh.: Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara). Në Irlandë është bërë një reformë e rëndësishme, si rezultat i të cilës sigurimi i cilësisë nga mekanizma të jashtëm, deri në njëfarë mase, organizohet nga vetë institucionet e arsimit të lartë. Irlanda ka përqafuar “qasjen e përshtatshmërisë së qëllimit”, sipas të cilës kontrolli përqendrohet kryesisht

te mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë brendapërbrenda vetë institucioneve. Këto ndryshime bazohen te përvoja në vite lidhur me sistemet e jashtme të sigurimit të cilësisë dhe, për këtë arsye, duhet të merren parasysh kur diskutohet për sigurimin e cilësisë në Evropën Juglindore.

Në fakt, vendet e Evropës Juglindore përballen me një sfidë të rëndësishme, e cila ka të bëjë me ngritjen e sistemeve të efektshme të jashtme të sigurimit të cilësisë në shkallë kombëtare. Për shkak të dimensionit të tyre të vogël, ato nuk arrijnë të trajtojnë një numër çështjesh që lidhen me sigurimin e cilësisë nga jashtë sistemit, përfshirë organizimin e analizave të pavarura nga ana e homologëve në shkallë kombëtare. Shoqata e Universiteteve Evropiane ka vënë në dukje se këto çështje duhet të trajtohen në nivel rajonal (SHUE, 2007). Përveç kësaj, Komunikata e Berlinit, e cila u miratua nga takimi i Ministrave të vendeve nënshkruese të Procesit Bolonjës në vitin 2003, thekson se vetë universitetet duhet të mbajnë përgjegjësinë kryesore për sigurimin e cilësisë. Sidoqoftë, deri më sot, vendet e Evropës Juglindore nuk i kanë kushtuar vëmendje e duhur krijimit të mekanizmave të shëndoshë të brendshëm të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë. Do të ishte e nevojshme që mekanizma të tilla të krijoheshin në nivel qendror, të plotësoheshin me personelin e përshtatshëm dhe të mbështeteshin te universitetet. Në Evropën Juglindore, nuk ka patur as debat informativ për balancimin e mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm të sigurimit të cilësisë.

Zhvillimet e tanishme në Evropë mund të paraqesin probleme të veçanta për vendet e Evropës Juglindore lidhur me sigurimin e cilësisë. Kohët e fundit është krijuar një regjistër i agjencive evropiane të sigurimit të cilësisë dhe vendet do të gjenden nën presion, gjithnjë e më të madh, që të përdorin agjencitë e kësaj liste. (Komisioni Evropian mbështet idenë se, për të përmbushur detyrimet kombëtare për sigurimin e cilësisë, një vend mund të përdorë çdonjërin nga organet të sigurimit të cilësisë që figurojnë në këtë regjistër.) Vetë madhësia e vendeve të Evropës Juglindore dhe, për rrjedhojë, grupi i mundshëm i inspektorëve homologë në shkallë kombëtare, krijojnë shqetësime nëse vendet e Evropës Juglindore do të arrijnë të regjistrojnë agjencitë e tyre kombëtare. Gjithashtu, këto agjenci ndoshta do ta kishin të vështirë të konkurronin në “tregun” në zhvillim e sipër të Evropës përse i përket sigurimit të cilësisë.

Struktura institucionale e fakulteteve të fuqishme dhe autonome nga pikëpamja ligjore brendapërbrenda universiteteve, qëndron në bazë të shumë problemeve që u nënvizuan më lart dhe, për rrjedhojë, pengon zhvillimin e universiteteve publike në

Evropën Juglindore. Kjo strukturë ka disa disavantazhe. Ajo nuk është efikase, meqënëse çdo fakultet i veçantë ofron një cikël të plotë kursesh (duke krijuar, kështu, mbivendosje të kurseve dhe programeve që ofrojnë fakultetet e tjera të të njëjtit universitet) dhe ka administratën e saj. Nuk është e efektshme sepse praktikat e mira, për shembull, lidhur me mekanizmat e sigurimit të cilësisë, mësimdhënien e mirë apo kurset shumëdisiplinore, nuk mund të përhapen në gjithë institucionin. Ajo nuk është transparente sepse fakultete të veçanta (ose dekanët e tyre) përpiqen të ndikojnë te parlamentet kombëtare që të miratojnë fonde për ta ose fonde shtesë.⁸ Gjithashtu, struktura krijon mundësi për praktika korruptive në ndarjen e burimeve dhe vlerësimet e studentëve. Së fundi, dhe ajo që është më e rëndësishme, struktura institucionale i pengon universitetet të krijojnë identitetin dhe misionin thelbësor, nëpërmjet të cileve mund të planifikohet zhvillimi i tyre, të punohet për avantazhe krahasuese dhe të caktohen burimet. Për rrjedhojë, në llojet e universiteteve që ndeshen në Evropën Juglindore, ka shkallë të lartë uniformiteti: universitete që nuk arrijnë të ofrojnë kurse, të cilet të jenë fleksibël, të jenë të përparuar dhe të kenë në qendër studentin. Gjithashtu, universitetet nuk arrijnë t'i përqendrojnë burimet e tyre të pakta në veprimtari kërkimore, ku ato kanë një epërsi të krahasueshme, përfshirë aleancat strategjike me institucione të tjera të rajonit të Evropës Juglindore dhe më gjerë. Përveç kësaj, mungesa e mekanizmave efektive publike të llogaridhënies do të thotë se nuk ekziston një kuadër për përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të këtyre institucioneve. Sigurisht, një strukturë organizative shumë e decentralizuar nuk është domosdoshmërisht pengesë për të qenë universitet i klasit botëror, siç e tregojnë shembujt e Universiteteve të Oksfordit dhe të Kembrixhit. Sidoqoftë, duke patur parasysh financimet bujare që marrin këto institucione nga shteti, sidomos për kërkimin shkencor, si dhe dhurimet e mëdha, niveli i burimeve që ato disponojnë është dukshëm krejt i ndryshëm nga niveli i burimeve që mund të mobilizojnë institucionet e Evropës Juglindore. Për më tepër, këto dy universitete kanë ruajtur një numër tiparesh të përbashkëta, duke krijuar ndërkohë emra të fuqishëm, në bazë të të cilëve departamentet dhe kolegjet tregtojnë shërbimet e tyre.

Njihen pak raste të suksesshme, siç është Universiteti i Tuzlës në Bosnjë-Hercegovinë dhe Universiteti i Malit të Zi, ku universitetet e kanë përmirësuar

⁸ Në këto vende, ekziston një problem edhe më i madh lidhur me qeverisjen: shumë politikanë të zgjedhur (dhe, në fakt, shumë nëpunës të lartë civilë në Ministrinë e Arsimit) vazhdojnë t'i mbajnë vendet e punës në mësimdhënie dhe/ose kërkim në universitetet e EJK-së.

performancën e tyre duke u integruar nga pikëpamja ligjore. Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë, Maqedoni — universitet privat — u integrua që me themelimin e tij në vitin 2005. Në Tuzël, një studim që u bë për universitetin, pesë vjet pas administrimit të bashkuar, vuri në dukje se ai i kishte ulur shpenzimet e përgjithshme nga buxheti i shtetit në masën 20 %, ndërkohë që kishte dyfishuar personelin, kishte trefishuar numrin e studentëve, kishte përmirësuar shërbimet e laboratorike dhe bibliotekare, si dhe kishte përshtatur fondet me qëllim që të shpërndante riskun (Banka Botërore, 2003). Gjatë këtij procesi, universiteti kishte ofruar gjithashtu më shumë zgjedhje për studentët, fleksibilitet më të madh të programeve dhe lidhje më të mirë me pedagogët, duke eliminuar mbingarkesën e punës të personelit akademik.


Por ligjet për integrimin e institucioneve nuk kanë qenë gjithmonë të efektshme. Për shembull, duket se kompromiset që janë bërë në Sllovaki, gjatë miratimit të legjislacionit përkatës, i kanë minuar përpjekjet për reformën dhe ndryshimet e rëndësishme nuk kanë qenë të shpejta. Procesi i reformës u parashikua si një qasje hap pas hapi, por u hodhën vetëm hapat e parë. Nga ana tjetër, në Slloveni, ligji përkatës asnjëherë nuk synoi që të çonte në krijimin e institucioneve, plotësisht të integruara (Kwiek, 2007). Këta shembuj ofrojnë një mësim të dobishëm për të gjitha vendet e Evropës Juglindore, të cilat tani e kanë miratuar legjislacionin e duhur për të ndryshuar strukturën institucionale të universiteteve të tyre. Kroacia ka kaluar tashmë nëpër një proces të gjatë dhe të vështirë të zbatimit të legjislacionit të saj për këtë çështje.

Në krahasim me vendet e tjera evropiane, shpenzimet publike për institucionet e arsimit të lartë, si përqindje e PBB-së, janë të ulta në të gjitha vendet e Evropës Juglindore. Për shembull, në vitin 2003, Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia dhe Rumania shpenzuan për këtë qëllim shumë më pak se 1 % të PBB-së, krahasuar me mesataren prej 1.1 % të 19 vendeve të Bashkimit Evropian (shih grafikun 6). Sllovenia është afër mesatares së BE-së.

As burimet e financimit publik, as ato të financimit privat nuk ofrojnë ndonjë stimul që fakultetet të përmirësojnë efikasitetin dhe të rrisin numrin e të diplomuarve. Fondet publike u shpërndahen universiteteve në bazë të treguesve të kapaciteteve akademike, siç janë numri i studentëve dhe pedagogëve. Përgjithësisht, universitetet marrin para të mjaftueshme vetëm për të mbuluar pagat, gjë që u lë atyre pak hapësirë për veprimtari të tjera përveç mësimdhënies. Për shembull, në Malin e Zi, grantet për kërkime jepen veçmas dhe vetëm në bazë të kërkesave për projekte të veçanta (Ziegele, 2007). Sidoqoftë, edhe atëherë kur buxhetet jepen të padetajuara në zëra të veçantë, këto fonde nuk mund të përdoren për veprimtari

kërkimore apo shërbime, për sa kohë që buxheti është i mjaftueshëm vetëm për të mbuluar rrogat.

Grafiku 6. Shpenzime për institucione arsimore, si përqindje e PBB-së, në vende të përzgjedhura



Burimi: Instituti i UNESCO-s për Statistikat, Beyond 20/20 Web Data Server, Versioni 7.4.

Ndërkohë që financimi nga ana e shtetit vazhdon të jetë relativisht i ulët, institucionet publike të arsimit të lartë kanë arritur të gjejnë burime nga taksat e shkollës. Sidoqoftë, taksat dhe financimi aktual publik ofrojnë bashkarisht stimulim për mbajtjen e studentëve në sistem, duke ulur në këtë mënyrë efikasitetin. Lejohet që institucionet publike të regjistrojnë sa më shumë studentë shtesë, që të kenë mundësi, përtej numrit, për të cilin marrin subvencione publike (në varësi të disa kërkesave për të respektuar hapësirat).⁹ Për më tepër, taksat që paguajnë këta studentë janë zakonisht shumë më të mëdha sesa subvencionet publike.¹⁰ Në të vërtetë, shumat e parave që këto institucione publike kërkojnë nga studentët që paguajnë taksa, mund të jenë shumë të mëdha. Në Kroaci, taksat vjetore të shkollës në universitetet publike shkojnë nga 680 euro në 1.150 euro. Universiteti i Malit të Zi kërkon një taksë vjetore prej 1.000 euro, krahasuar me 1.300 euro në sektorin privat të arsimit të lartë.¹¹ Ky nivel taksash ka mbizotëruar në vendet e Evropës Juglindore që nga fillimi i tranzicionit të tyre dhe, pjesërisht, shpjegon mungesën e numrit të madh të të regjistruarve në institucionet private. Për shembull, të

⁹ Sidoqoftë, në Maqedoni qeveria përcakton kuota për numrin e studentëve që duhet të paguajnë taksa të plota.

¹⁰ Gjithsesi, nuk është bërë ende ndonjë analizë e marrëdhënieve mes taksave të vendosura nga universitetet dhe shpenzimeve të plota ose të pjeshme të studentëve që paguajnë taksa.

¹¹ Korrespondencë private e rektorëve të universiteteve me autorët, tetor 2007.


ardhurat që humbasin nga burimet publike, kur studentët mbërrijnë në fund të periudhës së financimit të tyre publik, mund të kompensohen me shpejtësi duke i transferuar këta studentë tek grupi i atyre që paguajnë taksa. Ky ndryshim krijon stimuj për t'i mbajtur studentët në sistem, përtej periudhës së parashikuar të studimeve. Gjithashtu, ka shumë të dhëna jozyrtare, sipas të cilave pedagogët kërkojnë që studentët të paguajnë për të marrë provimet.

Burimet private janë të përqendruara në disa fakultete dhe nuk përdoren për të mirën e institucionit në tërësi. Fakultetet e drejtësisë dhe të ekonomisë përfaqësojnë pjesën dërrmuese të burimeve private të financimit në universitetet publike të Evropës Juglindore, ndërsa fakultetet e tjera vuajnë për fonde. Duke patur parasysh pavarësinë që i njeh ligji fakulteteve, ato nuk kanë asnjë detyrim ndaj të tretëve përsa i takon të ardhurave nga taksat që paguajnë studentët, qoftë edhe për struktura (gjë që do të ishte në interesin e tyre), siç janë zyrat e centralizuara të transferimit të teknologjisë, bibliotekat, apo strukturat e veçanta për studentët me aftësi të kufizuara.

Në Evropën Juglindore, sistemet e arsimit të lartë nuk janë të përgatitura për dy detyra të tjera të rëndësishme që lidhen me kontributin për aftësinë konkurruese të vendeve të tyre përkatëse: asimilimi i dijeve dhe modernizimi. Këto mangësi pasqyrojnë kufizimet e mëdha të kompanive private lidhur me kërkesën për kërkimin shkencor dhe zhvillimin. Pjesa dërrmuese e personelit të angazhuar në kërkimin shkencor dhe zhvillim është në sektorin publik. Kjo kategori ose është punësuar drejtpërsëdrejti nga shteti, ose punon në arsimin e lartë (universitetet private merren shumë pak me kërkim dhe zhvillim). Siç shihet në grafikun 7, në disa vende, si Kroacia, Sllovenia dhe Rumania, sektori i biznesit mbulon mbi 40 % të shpenzimeve kombëtare për kërkim dhe zhvillim. Sidoqoftë, në vende të tjera të Evropës Juglindore, shpenzimet e sektorit privat në këtë drejtim janë të papërfillshme. Synimi i Bashkimit Evropian është që këto shpenzime të arrijnë në 3 % të PBB-së, ndërsa dy të tretat e kësaj shume duhet të kërkohen nga sektori privat (këto dy nivele janë, përkatësisht, 1.8 % dhe 55 %).¹² Përgjithësisht, në Evropën Juglindore, duket se kërkesa e ulët për kërkimin dhe zhvillimin është një problem më i madh sesa ofrimi i tyre, të paktën siç perceptohet, nga sektori i biznesit (Radosevic, 2007).

¹² EUROSTAT, “Statistikat në Fokus: Shkenca dhe Teknologjia,” 23 (2007). Fatkeqësisht, shifrat për BE nuk janë drejtpërdrejt të krahasueshme me shifrat për vendet e EJT-së në grafikun 7.

**Grafiku 7. Shpenzime të përgjithshme për kërkimin dhe zhvillimin (GERD),
në disa vende të përzgjedhura, 2004**



Në Evropën Juglindore, sistemet e kërkimit dhe zhvillimit kontribuojnë pak për aftësinë konkurruese të vendeve përkatëse përsa i takon modernizimit. Kroacia është, dukshëm, vendi më i avancuar në rajon. Analiza në grup tregon se ajo është më afër vendeve të reja anëtare të Bashkimit Evropian, ndërsa vendet e tjera të Evropës Juglindore formojnë një grupim më vete. Brenda këtij grupimi të fundit, Shqipëria dhe Bosnjë-Hercegovina janë më të dobëtat përsa i përket modernizimit (Radosević, 2007). Ky konkluzion pasqyrohet në numrin e kufizuar të patentave që kanë mundur të sigurojnë vendet e Evropës Juglindore (shih tabelën 4). Vendet e Ballkanit Perëndimor janë shumë prapa vendeve të tjera evropiane përsa i përket kërkesave për patenta. Në nivel rajonal, Kroacia ka numrin më lartë të kërkesave për patenta, por është ende shumë prapa. Sllovenisë, e cila, nga ana e saj, ka një performancë që arrin në 25 % të

mesatares së Bashkimit Evropian. Gjithashtu, vendet e Evropës Juglindore duket se thithin shumë pak investime të huaja të drejtëpërdrejta për kërkimin (sugj. shkencor) dhe zhvillimin.


Tabela 4. Numri mesatar i kërkesave për patenta që paraqiten në Zyrën Evropiane të Patentave, në vit, për çdo 100.000 banorë të vendeve të EJT-së, 1997–2003

| | | | |
|----------------------|------|-----------|-------|
| Kroacia | 0.42 | Austria | 12.92 |
| Bullgaria | 0.12 | Sllovenia | 1.98 |
| Serbia dhe Mali i Zi | 0.06 | Hungaria | 0.84 |
| Rumania | 0.03 | Greqia | 0.51 |
| Bosnjë-Hercegovina | 0.02 | Turkia | 0.05 |
| IRJ e Maqedonisë | 0.01 | BE 15 | 11.96 |
| Shqipëria | 0.01 | BE 25 | 10.39 |

Burimi: Zyra Evropiane e Patentave, <http://www.epo.org> (vizituar në dhjetor 2007).


Në Evropën Juglindore, aspekti i kontributit të sistemeve të kërkimit dhe zhvillimit është i ngjashëm me aspektin e produktit: numri i punonjësve shkencorë është relativisht i vogël dhe shpenzime tejet të ulëta. Sërish, Kroacia është përpara vendeve të tjera të rajonit, ku financimi për kërkimin dhe zhvillimin zë 1.22 % të PBB-së. Në të vërtetë, Kroacia ka 6.66 punonjës shkencorë për 1.000 individë në forcën e punës, numër ky më i lartë sesa mesatarja prej 5.4 e 15 vendeve të Bashkimit Evropian (shih grafikun 8). Vende të tjera të Ballkanit Perëndimor kanë më pak se gjysma e këtij raporti, i cili, duke filluar nga mesi i viteve nëntëdhjetë, ka ardhur gradualisht, por gjithnjë, në rënie në Serbi, Mali i Zi dhe Maqedoni. Për vende të tjera përveç Kroacisë, financimi i përgjithshëm për kërkimin dhe zhvillimin është përgjithësisht më pak se 1 %; në Serbi, financimi ka pësuar rënie të shpejtë që nga viti 2000, kur ai arriti në 2 % (shih tabelën 9). Duke patur parasysh dimensionin e ekonomive të këtyre vendeve, kjo nënkupton nivel shumë të ulët financimi (p.sh.: në vitin 2003, Maqedonia shpenzoi 23 milion euro). Përsa i përket volumit të shpenzimeve, Kroacia është faktikisht një devijim domethënës nga rajoni (në vitin 2003, ajo shpenzoi 300 milion euro) — më shumë madje se edhe Rumania apo Bullgaria.

**Grafiku 8. Raporti i punonjësve shkencorë për 1.000 punonjës të forcës së punës,
në vende të përzgjedhura, 2003**



Burimi: Gesellschaft zur Foerderung der Forschung (Shoqata për Nxitje dhe Kërkim Shkencor) (2006).


**Grafiku 9. Shpenzime të brendshme bruto për kërkim dhe zhvillim, vende të përzgjedhura,
vite të ndryshme (milion euro)**



Burimi: Gesellschaft zur Foerderung der Forschung (2006).

Shënim: Përqindjet për Serbinë dhe Malin e Zi në vitet 1997, 2000, 2001; për Bosnjën-Hercegovinën, 2000 dhe 2003.

Grafiku 10. Shpenzime për kërkim dhe zhvillim në E.JL si përqindje e PBB-së, 1999–2004



Burimi: Banka Botërore (2005); Seksioni i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (2004); banka e të dhënave të UNESCO-s për Institutin e Statistikave, Shkencës dhe Teknologjisë.

II. Çfarë duhet bërë?

Gama dhe dimensionimi i problemeve, me të cilat përballen sistemet e arsimit të lartë, të kërkimit shkencor dhe zhvillimit në vendet e Evropës Juglindore, kërkojnë një reagim në shkallë të gjërë, i cili do të realizohet në një periudhë të shtrirë kohore. Kjo pjesë ndalet te përshkrimi i zgjidhjeve të mundshme të përshtatshme ndaj këtyre sfidave dhe, më pas, merr në shqyrtim mënyrën sesi mund të ndërmerren reformat këto vende. Pjesa në vijim jep një ide të përgjithshme për mënyrën sesi bashkëpunimi rajonal mund t'i ndihmojë vendet e rajonit për të ecur përpara.

Me qëllim që të ekzistojë një kuadër i përshtatshëm ligjor, sistemi i financimit publik, i cili ofron stimuj që institucionet të përmbushin misionet e tyre përkatëse, është kushti i parë që sistemet e arsimit të lartë në rajon të jenë të suksesshme. Në një periudhë afatmesme, ky objektivi mund të arrihet vetëm duke krijuar mekanizma financimi me bazë performancën. Mekanizma të tilla shfaqen në një larmi modelesh, por kërkesat administrative dhe rregullatore janë të rëndësishme. Sidoqoftë, përvoja e vendeve të tjera në mbarë botën tregon se shuma, relativisht të vogla, parash (d.m.th., më pak se 10 % e buxheteve të përgjithshme të universiteteve) mund të kenë një impakt të rëndësishëm mbi veprimtarinë e institucioneve. Kështu ndodh, sidomos, nëse për shpërndarjen e investimeve, krahasuar me shpenzimet periodike, përdoren mekanizma me bazë performancën (Salmi dhe Hauptman, 2005). Që të jenë të efektshme, këto mekanizma duhet të bëjnë të mundur që institucionet të hartojnë dhe t'u përgjigjen strategjive të qarta për arsimin e lartë, si dhe të ofrojnë stimuj për një arsim të lartë dhe kërkim efikas dhe të efektshëm. Në kuadrin e Evropës Juglindore, këto objektiva kërkojnë konceptimin nga e para – dhe rinegociimin – e asaj çka nënkupton që një institucion arsimor të jetë autonom. Aktualisht, në Evropën Juglindore, institucionet e arsimit të lartë argumentojnë se autonomi do të thotë mungesë të ndikimit të shtetit dhe është e vetmja mënyrë, me anë të së cilës ato mund të mbrojnë vlerën thelbësore të lirisë akademike. Në pjesën tjetër të Evropës, koncepti i lirisë akademike të universiteteve është ndërthurur me llogaridhënien përpara shtetit për performancën e tyre.

Ristrukturimi i universiteteve nga pikëpamja e organizimit është një kusht tjetër thelbësor që sistemet e arsimit të lartë të jenë të suksesshme. Kjo detyrë kërkon eliminimin e

statusit të veçantë ligjor që kanë fakultete të veçanta dhe krijimin e universitetit si njësinë kryesore ligjore. Ndër funksionet kryesore që duhet t'i caktohen një strukture qendrore të menaxhimit përfshihen:

- drejtimi i përgjithshëm dhe planifikimi strategjik i institucionit;
- marrja e fondeve publike për veprimtari të ndryshme (d.m.th., që nuk kanë lidhje me projekte) të institucionit në një llogari qendrore të universitetit;
- administrimi i flukseve të fondeve për universitetin, në përputhje me prioritetet strategjike;
- përgatitja e një buxheti të përgjithshëm për universitetin, përfshirë të ardhurat që mbliidhen nga departamente të veçanta;
- punësimi i gjithë personelit akademik dhe joakademik;
- administrimi i pasurive dhe asetëve të tjera të universitetit;
- ofrimi i shërbimeve dhe funksioneve qendrore (ky funksion mund të përfshijë ngritjen e një zyrë qendrore të sigurimit të cilësisë, grumbullimin dhe ofrimin e të dhënave, etj.);
- përgjegjësia për llogaridhënien përpara qeverisë dhe publikut për arritjet e universitetit;
- roli kryesor në skemat e shpërblimit të akademikëve; dhe,
- përfaqësimi i përgjithshëm i institucionit.

Gjithashtu, universitetet duhet të marrin në shqyrtim krijimin e një organi të jashtëm drejtues (d.m.th., një bord të universitetit), i cili duhet të përfshijë përfaqësues nga grupe të tilla interesi, si komuniteti i biznesit dhe administrata vendore. Bordi drejtues luan një rol thelbësor për përcaktimin e drejtimit strategjik të një institucioni të arsimit të lartë, dhe përbën instancën e parë të mbikëqyrjes (në vend të shtetit). Aktualisht, në vendet e Evropës Juglindore, shumica e ligjeve parashikojnë që universitetet të kenë organe drejtuese, por këto nuk mund të luajnë ndonjë rol të efektshëm në institucione, faktikisht të copëzuara.

Këto ndryshime kërkojnë vullnet politik nga ana e qeverive. Ristrukturimi i universiteteve shtetërore kërkon ndryshime të thella në shpërndarjen e pushtetit dhe të parave brenda këtyre institucioneve, zvogëlimin e fushës së veprimtarisë të praktikave korruptive dhe, nëse realizohet plotësisht, çon në mjaftueshmëri të personelit. Prandaj nuk është çudi që këto

reforma ndeshin në rezistencë. Zbatimi i plotë i këtyre reformave kërkon që, gjatë disa viteve, t'u kushtohet një vëmendje e vazhdueshme një numri të madh hollësish. Përvoja e Sllovakisë dhe Sllovenisë tregon se realizimi i hollësive në mënyrë të gabuar mund të dëmtojë të gjithë reformën (shih më sipër). Prandaj, qeveritë dhe, veçanërisht, ministrinë e arsimit të lartë duhet të angazhohen energjikisht në secilën fazë të procesit të reformës.


Kapacitetet menaxhuese të universiteteve duhet të rriten në mënyrë të ndjeshme me qëllim që ato bëhen më efikase dhe të orientohen më shumë në drejtim të performancës. Qeveritë duhet të ofrojnë mbështetje për këtë punë, e cila duhet të shtrihet në disa vite. Përveç krijimit të kapaciteteve të menaxherëve të veçantë (siç është rektori), duhen përmirësuar dhe kapacitetet e përgjithshme në sistemet e të dhënave dhe informacionit (për qëllime të listës së pagave, kontabilitetit dhe pranimeve të reja). Këto sisteme bëjnë të mundur që rektorati ta menaxhojë universitetin dhe të luajë rol jetik për krijimin e një sistemi të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Gjithashtu, qeveritë mund të kenë dëshirë të marrin në shqyrtim nëse për të gjithë universitetet, në një vend të dhënë, mund të krijohet një sistem i përbashkët informacioni me qëllim që të lehtësohet llogaridhënia përpara publikut dhe raportimi në qeveri. Siç përshkruhet më poshtë, në krijimin e mekanizmave të brendshëm, të efektshëm të sigurimit të cilësisë, administrata qendrore e universitetit luan rolin kryesor. Që të jetë plotësisht efikase, administrata qendrore duhet të jetë e aftë të mbledhë fonde të mjaftueshme për shpenzimet e përgjithshme të universitetit, të cilat i lejojnë të kryejnë detyrat e tyre. Përsëri, shumë pak institucione i kanë ndjekur këto strategji me njëfarë suksesi (p.sh.: Universiteti i Malit të Zi, ku shpenzimet e përgjithshme arrijnë në masën 20 %, gjë që përputhet me praktikën e shumë universiteteve të Evropës Perëndimore). Përkundrazi, në nivelin e sotëm, administrata qendrore, me shumicën e institucioneve të paintegruara, ndesh në vështirësi për mbulimin e shpenzimeve të përgjithshme deri në masën 3 % (aktualisht, kjo është situata në Universitetin e Zagrebit).¹³

Sistemet e arsimit të lartë në vendet e rajonit të Evropës Juglindore janë të pabalancuara. Në çdo vend, gjeografinë e arsimit të lartë e përbëjnë një ose, e shumta, dy universitete. Numri i studentëve të regjistruar në këto universitete shkon nga 40.000 deri në 70.000, ndërsa ato tërheqin rreth gjysmën (nganjëherë më shumë) e gjithë studentëve në vend. Institucionet e mëdha, siç është Universiteti i Zagrebit, Ljubljanës, Sarajevës dhe Beogradit, gëzojnë prestigj shumë të lartë politik në sistemet përkatëse të arsimit të lartë. Për këtë arsye,

¹³ Korrespondenca private e rektorëve të universiteteve me autorët, tetor 2007.

vonesat përse i përket reformave në këto institucione do të kenë një impakt të madh te këto sisteme. Është e rëndësishme të vërehet se dimensionin e universiteteve duhet të shkojë paralelisht me misionin e tyre. Kështu, në arsimin e lartë, nuk ka asnjë model që të jetë i një formati të përshtatshëm për të gjithë. Institucionet e mëdha që administrohen mirë, kanë epërsi potenciale përse i përket ekonomive të shkallës në mësimdhënie dhe kërkim. Sidoqoftë, është me interes të vërehet se shumë universitete që kanë renditje të mirë në klasifikimin botëror— përfshirë Harvardin, Stenfordin, MIT-in, Oksfordin dhe Kembrixhin, kanë dimensione të ngjashme, d.m.th., numri i studentëve të regjistruar në këto universitete shkon nga 10.000 në 20.000 (Banka Botërore, 2007).

Grafiku 11. Sistemet e pabalancuara të arsimit të lartë: Rasti i Bosnjë-Hercegovinës



Burimi: Federata e Bosnjë-Hercegovinës, Zyra Federale e Statistikave, “Analizë e përmuajshme statistikore” <http://www.fzs.ba/Eng/mjeng.htm> (vizituar në dhjetor 2007).

Në sistemet më të balancuara të arsimit të lartë, që përmbushin nevojat e ndryshme — përfshirë nevojat rajonale — mund të përfshihen sektori i përmirësuar politeknik dhe institucionet e specializuara të arsimit të lartë. Në këtë aspekt, universitetet evropiane janë

zhvilluar në mënyra të ndryshme. Në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Gjermani, universitetet që ofrojnë një gamë të plotë programesh dhe kombinojnë mësimdhënien me kërkimin, shihen si standardi i artë. Këto institucione, të cilat administrohen, kryesisht në mënyrë të centralizuar,¹⁴ janë të afta të ushtrojnë kontroll mbi ekonomitë e shkallës dhe të arrijnë masën kritike që nevojitet për kërkime shkencore të cilësisë së lartë. Nga ana tjetër, Polonia dhe një numër vendesh të tjera të Evropës Lindore kanë dëshmuar shtrirjen e universiteteve të specializuara, që kanë përqendruar vëmendjen, për shembull, te studimet ekonomike ose mjekësore.

Sfida, me të cilën përballen vendet e Evropës Juglindore, lidhet me krijimin në një periudhë afatmesme, të një numri të kënaqshëm universitetesh me programe mësimore të efektshme dhe të plota. Aktualisht, institucionet më të mëdha janë shpeshherë ato më konservatoret përsa i përket strukturës organizative, modernizimit të programit mësimor dhe pedagogjisë. Gjithashtu, ato janë më të fuqishmet politikisht në vendet e tyre përkatëse dhe i kanë rezistuar integritit ligjor. Prandaj, duhet marrë në shqyrtim alternativa nëse këto institucione të mëdha duhet të ndahen. Kështu, në një periudhë afatshkurtër, do të vihej në program krijimi i një model institucional më të efektshëm. Argumentet **në favor të ndarjes së strukturave institucionale ekzistuese** duhet të balancohen me shumë kujdes, përkundrejt pasojave të mundshme negative për strukturën e të ardhurave, punën ndër-disiplinore, arsimin parauniversitar dhe universitar që shkon përtej përgatitjes të teknikëve të lartë. Sidoqoftë, nëse ndiqet kjo alternativë, do të ishte e rëndësishme të bëhej kujdes që, pas ndarjes, çdo grup i formuar rishtas të përfshinte dy ose tre institucione të plota, jo thjesht fakultete përbërëse. Duke patur parasysh ndikimin politik të këtyre institucioneve, rruga e reformave krijon pengesa serioze për ekonominë politike. Megjithatë, ndoshta sfida kryesore, me të cilën përballen vendet e Evropës Juglindore është që t'i bëjnë këto institucione më të efektshme.

Në një periudhë afatgjatë, vendet e Evropës Juglindore duhet të marrin në shqyrtim politika që inkurajojnë larminë e institucioneve, të cilat ofrojnë programe që janë më shumë të orientuara në drejtim të profesioneve, dhe afate më të përshtatshme përsa i përket kohëzgjatjes së studimeve, vendndodhjes dhe modaliteteve të mësimdhënies. Teorikisht, ekziston mundësia që një institucion i caktuar të shndërrohet në një institucion me mision dhe qëllim të ndryshëm. Sidoqoftë, në praktikë, vendet në mbarë botën kanë konstatuar se

¹⁴ Siç vërehet më sipër, ky nuk është rasti i Universitetit të Oksfordit dhe të Kembrixhit dhe, në një masë më të vogël, as i Universitetit të Durhamit.

për të ofruar këto forma dhe lloje të reja programesh ka qenë i nevojshëm krijimi i institucioneve të reja. Institucione të tilla mund të marrin forma të ndryshme. Institucionet, relativisht tërësore, i kushtojnë vëmendje ofrimit të arsimit profesional (p.sh.: kolegjet shtetërore në Norvegji dhe institutet politeknike në Finlandë). Institucionet me dy pjesë ofrojnë programe të lëndëve profesionale për kalimin në tregun e punës dhe programe akademike që mund të transferohen në universitet. Kolegjet e komuniteteve në Shtetet e Bashkuara dhe Kanada, Institutet Universitare të Teknologjisë (*Instituts universitaires de technologie*) në Francë, *Fachhochschulen* (Universitetet e Shkencave të Aplikuara) në Gjermani, si dhe kolegjet pas përfundimit të arsimit të mesëm të detyrueshëm në Mbretërinë e Bashkuar, janë shembuj të institucioneve të këtij lloji. Natyra e dyzuar e këtyre institucioneve bën që ato të kategorizohen si ISCED 5A ose 5B (i njëjti emërtim si diploma e universitetit), apo madje ISCED 6, si në rastin e *Fachhochschulen*-ve gjermane (të cilat mund të japin diploma master).¹⁵ Në çdo rast, duke patur parasysh strukturën aktuale të sektorit të arsimit të lartë në Evropën Juglindore, kostot dhe pengesat për krijimin e institucioneve të reja, kuadrin shoqëruës rregullator, si dhe rëndësinë e prioriteteve të tjera, krijimi i këtyre institucioneve parashikohet të realizohet në një periudhë afatmesme.

Përmirësimi i mekanizmave të financimit

Reformat janë të nevojshme si përsa i përket mekanizmave të financimit që shpërndajnë burimet mes qeverive dhe institucioneve të arsimit të lartë, ashtu edhe përsa i përket mekanizmave që shpërndajnë burimet mes njësisve përbërëse të këtyre institucioneve. Në përputhje me transformimin drejt një institucioni të integruar, fondet për mësimdhënien është më mirë t'i kalojnë administratës qendrore të një universiteti, sesa fakulteteve apo departamenteve të tij të veçanta. Është relativisht e lehtë për të deklaruar parimet, ku mbështetet kjo shpërndarje fondesh. Financimi duhet:

- të mbështetet te të dhënat më të fundit;
- të jetë transparent (kriter) kryesor duhet të jetë numri i studentëve);
- të bazohet në kritere objektive;
- të planifikohet për të dhënë stimuj me qëllim që universitetet të përmbushin pikësynime të rëndësishme nga pikëpamja sociale (p.sh.: barazia) dhe objektiva,

¹⁵ Shih Grubb (2003).

për të cilat ofruesi dhe përfituesit e fondeve kanë shprehur mirëkuptim (p.sh.: brenda kuadrit të kontratave të performancës); dhe,

- të synojë nxitjen e efektshmërisë dhe dobishmërisë.

Në mbarë botën, ekziston një përvojë e konsiderueshme lidhur me procedurat e financimit të arsimit të lartë, të cilat përputhen me këto parime (Salmi dhe Hauptman, 2006). Pasi merr një financim shtetëror, institucioni duhet të tregohet mjaft elastik lidhur me mënyrën si duhet t'i shpenzojë këto burime me qëllim që të arrijë objektivat e përcaktuara.

Administrata qendrore duhet të jetë përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit lidhur me shpërndarjen e fondeve brendapërbrenda institucioneve. Përveç kësaj, standardi i matjes që përdor qeveria për të përlllogaritur shumat për institucione të veçanta (për shembull, numri i studentëve në degë të ndryshme) nuk duhet të përdoret automatikisht nga institucioni kur bën shpërndarjen e buxhetit të përgjithshëm mes fakulteteve dhe departamenteve. Ndonëse objektivat e institucioneve duhet të jenë të përfshira në strategjinë (kombëtare) për arsimin e lartë, universiteteve duhet të kenë objektiva specifike dhe, në këtë mënyrë, shpërndarjen e fondeve brendapërbrenda tyre duhet ta bëjnë në përputhje me këto objektiva. Përveç kësaj, të ardhurat e grumbulluara nga nën-njësitë (p.sh.: fakultetet dhe departamentet), duhet të jenë të përfshira në buxhetin e institucionit dhe një pjesë e këtyre të ardhurave, për të cilat është rënë dakord, duhet të shfrytëzohen për qëllime më të gjera të institucionit.

Për të rritur numrin e pranimeve në arsimin e lartë dhe për të eliminuar pabarazinë, subvencionet publike për taksat e shkollës duhet të synojnë studentët me të ardhura të pamjaftueshme. Aktualisht, studentët me rezultatet më të mira në provimet e pranimit në shkollën e lartë përfitojnë financime publike për të mbuluar taksat e shkollës. Ndonëse për rajonin nuk ka të dhëna të sakta për krahasime të bazuara, faktet tregojnë se, në pjesën dërrmuese, këta studentë vijnë nga familje në gjendje të mirë ekonomike. Përveç faktit që kanë prindër të arsimuar dhe me të ardhura më të mëdha, gjë që përbën një avantazh, këta studentë kanë mundur të ndjekin shkolla më të mira fillore dhe të mesme, si dhe kanë marrë mësim private për t'u përgatitur për provimet e pranimit.¹⁶ Kanalizimi i burimeve publike te

¹⁶ Ka shumë fakte të besueshme, përfshirë faktet jozyrtare, lidhur me praktikën korruptive në procedurat e pranimit në shkollën e lartë, të cilat gjithashtu favorizojnë familjet në gjendje më të mirë ekonomike. Ky lloj korupsioni përbën një arsye të fortë që po i shtyn të gjitha vendet e Evropës Juglindore (me përjashtim të Serbisë) të përfshijnë në përfundim të arsimit të mesëm një provim të jashtëm – Maturën Shtetërore, provim ky që gjithashtu mundëson pranimin në shkollën e lartë. Është me interes të vërehet se fakultetet që shprehin rezistencë ndaj përfshirjes së

studentët që vijnë nga familje me të ardhura më të pakta (dhe që përmbushin kërkesat e përcaktuara për praninë në shkollën e lartë), duke e vënë theksin veçanërisht te sigurimi i shanseve të barabarta për pakicat, do të ofronte epërsitë e zgjerimit të mundësive dhe nxitjes së barazisë. Pa dyshim, për realizimin e kësaj detyre nevojiten kapacitete që mundësojnë grumbullimin dhe verifikimin e të dhënave për ardhurat e studentëve dhe të familjeve të tyre. Fatkeqësisht, ky funksion nuk është aktualisht i mundshëm në shumicën e vendeve të Evropës Juglindore.

Dhënia e financimeve është mënyra më efektshme për uljen e shpenzimeve të arsimit të lartë për individë nga familje me të ardhura të pamjaftueshme. Gjithashtu, skemat që ofrojnë kredi për studentët mund të kontribuojnë që studentët më të varfër t'i kapërcejnë kufizimet financiare.¹⁷ Sidoqoftë, skema të tilla kërkojnë një infrastrukturë administrative mjaft të fuqishme. Së paku, duhet të ekzistojnë:

- mekanizma për të bërë vlerësimin nëse një student i plotëson apo jo kriteret për të marrë kredi (p.sh.: të ardhurat e verifikueshme të prindërve ose të familjes, konfidencialiteti, aftësia për të përmbushur kërkesat që kulmojnë në çdo fillim viti shkollor);
- kapacitete për grumbullimin e shlyerjeve për një periudhë të zgjatur kohore pasi studenti diplomohet (një sfidë e veçantë kjo për vendet e Evropës Juglindore, ku një numër i madh i të rinjve ose janë të papunë në fazat e hershme të karrierës së tyre, ose zgjedhin të emigrojnë jashtë vendit); dhe,
- kuadri ligjor dhe kapacitetet administrative me qëllim që kontratat për grumbullimin e borxheve të papaguara të zbatohen në mënyrë të besueshme.

Disa nga këto funksione mund t'i kryejnë bankat private. Të gjithë skemat e kredive për studentët kërkojnë një lloj financimi publik, nëpërmjet normave më të ulëta të interesit, ofrimit të periudhave të faljes, mbajtjes së një pjese të caktuar të riskut të kredisë nga ana e shtetit, sesa mbajtjes së tij të plotë nga bankat private, si dhe anulimit të detyrimeve të papaguara. Në qoftë se

Maturës Shtetërore, si bazë për hyrjen në shkollën e lartë, janë po ato fakultete që grumbullojnë të ardhura të shpërpjestuara nga tarifatat e provimit të pranimit (d.m.th., të ardhura që i tejkalojnë ndjeshëm kostot e këtyre provimeve).

¹⁷ Sigurisht, nuk është e nevojshme që skemat, të cilat ofrojnë kredi, të synojnë vetëm studentët më të varfër. Sidoqoftë, shumica e subvencioneve që shkojnë për studentët më të varfër, duhet të jetë më e madhe, sesa shumica e kredive. Duhet nënvizuar se studentët më të varfër kanë një ndërveprim më të ulët me sistemin bankar dhe, kështu, janë më të tërhequr kur është fjala për marrjen e kredive.

skema nuk do të ndërtohej siç duhet dhe/ose do të administrohej në mënyrë të gabuar — për shembull, duke patur më shumë raste të mosshlyerjes së detyrimeve nga ç'pritet, duke mos i ndjekur nga afër të diplomuarit, ose duke përdorur subvencionime me norma të larta interesi — kostot mund të ishin aq të larta sa një skemë e thjeshtë granti do t'i kushtonte qeverisë më pak para dhe do të arrinte një mbulim më të mirë të shtresës së synuar (Ziderman, 2005). Përveç kësaj, shteti duhet të ofrojë një kuadër të përgjithshëm për sistemet e kredive për studentët, me qëllim që ato të respektojnë më shumë prioritetet e shtetit, sesa ato të bankave. Në qoftë se në vendet e Evropës Juglindore do të plotësohen kushtet për përfshirjen e një skeme të efektshme të kredive për studentët, do të jetë e nevojshme që ky sistem të kontrollohet me kujdes.

Rritja e flukseve të të ardhurave të universiteteve nuk nënkupton thjesht grumbullimin e taksave të shkollës. Universitetet e Evropës Juglindore duhet të dëshmojnë vlerën e shtuar që ato mund t'i ofrojnë sektorit privat, si dhe shoqërisë në përgjithësi, duke i bërë rezultatet e kërkimit të arritshme, duke siguruar transferimin e teknologjisë, si dhe duke ofruar një larmi shërbimesh konsulente.¹⁸ Të gjitha këto veprimtari mund të ofrohen në këmbim të tarifave, në bazë të shpenzimeve të transportit dhe të një politike të qartë të çmimeve. Të gjitha këto veprimtari duhet të drejtohen me profesionalizëm, d.m.th., nëpërmjet njësive qendrore të specializuara të universitetit, siç janë qendrat kërkimore dhe të transferimit të teknologjisë, si dhe njësitë e centralizuara të shërbimeve. Nëse këto njësi e tregojnë se janë të dobishme për veprimtaritë e një fakulteti të caktuar dhe për nivelin e departamentit, ato do të arrijnë të vërtetojnë pse shpenzimet e përgjithshme janë të dobishme për njësitë e decentralizuara të universitetit dhe, në këtë mënyrë, bëhen katalizatorë për integrimin e tyre.

Komisioni Evropian, nëpërmjet programeve të tij kuadër për kërkimin, nxit institucionet që të krijojnë modele të shpenzimeve të plota ekonomike.¹⁹ Me qëllim që të konkurrojnë në nivel evropian për fonde në fushën e kërkimit dhe që çmimet për veprimtaritë e tyre t'i caktojnë në bazë të shpenzimeve transparente në përgjithësi, universitetet e Evropës Juglindore duhet t'i arrijnë këto modele të shpenzimeve të plota, hap ky për të cilin, aktualisht, shumica janë të papërgatitur.

¹⁸ Gjithashtu, universitetet zakonisht pritet të kenë një funksion të shërbimit në komunitet.

¹⁹ Shih faqen e internetit të BE-së për këtë çështje, http://ec.europa.eu/research/fp7/index_en.cfm (vizituar në shkurt 2008).

Përmirësimi i cilësisë

Vendet që marrin pjesë në Procesin e Bolonjës, me anë të cilit synohet të bëhet ekuivalentimi i diplomave të arsimit të lartë në gjithë Evropën dhe të mbështetet lëvizja e studentëve dhe akademikëve (shih kutinë 1), u jep atyre një mundësi shumë të madhe për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxënit —gjë që ende nuk është shfrytëzuar në mënyrë të kënaqshme. Kjo mundësi mund të vijë nga disa zhvillime që lidhen me të. Gjatë rishikimit të programeve mësimore, universitetet duhet të kenë parasysh që:

- të krijojnë rezultate të qarta të të nxënit për kurset, duke e vënë theksin te kualifikimi dhe zbatueshmëria e dijeve, dhe të ulin në mënyrë të ndjeshme kërkesat për përsëritjen mekanike;
- t'u lejojnë mësuesve hapësira në mënyrën sesi ata përmbushin objektivat lidhur me rezultatet e të nxënit, duke i bërë ata të kuptojnë sesa ndryshe i kanë trajtuar rezultatet e kërkuara të të nxënit institucione dhe vende të ndryshme (p.sh.: në kontekstin e zhvillimit të vazhdueshëm të kuadrit kombëtar të kritereve;)
- të përfshijnë në këto veprimtari grupe të tjera të interesit, veçanërisht, komunitetin e biznesit;
- të krijojnë qasje të reja ndaj vlerësimit të studentëve, të cilat kontribuojnë që studentët të planifikojnë ecurinë e tyre, duke përdorur metoda objektive dhe transparente; dhe,
- t'i japin fund varësisë së madhe nga provimet e fundvitit.

Ka të ngjarë që shumica e pedagogëve të ketë nevojë për training me qëllim që të përmbushin kërkesat e reja të programeve dhe të vlerësimit. Ky training kërkon jo vetëm mbështetje të specializuar, përfshirë financimin për një qëllim të caktuar, por edhe udhëheqje efektive politike në mënyrë që të kapërcehet rezistenca dhe të ofrohen stimuj. Shumë prej këtyre ndryshimeve mund të realizohen duke zbatuar siç duhet mekanizmat ekzistuese evropiane për mundësinë e lëvizjes, siç është Sistemi Evropian i Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS), ose Plotësimi i Diplomës (DS), për të cilat disponohen fonde nga burime të ndryshme. Vendet e Evropës Juglindore duhet të inkurajohen për të krijuar ekipet e tyre të mbështetësve të Procesit të Bolonjës, mundësisht me idenë e organizimit të konsultimeve në nivel rajonal, dhe të marrin pjesë plotësisht në diskutimet e vazhdueshme në këtë fushë, në nivel evropian.

Kutia 1: Procesi i Bolonjës

Synimi i Procesit të Bolonjës është që, deri në vitin 2010, të krijohet Zona Evropiane e Arsimit të Lartë, në të cilën studentët të kenë mundësi të zgjedhin mes një numri të madh dhe transparent kursesh të cilësisë së lartë, si dhe të përfitojnë nga procedurat efikase të njohjes. Deklarata e Bolonjës e qershorit 1999 vuri në lëvizje një sërë reformash që nevojiten për ta bërë arsimin e lartë në Evropë më të përputhshëm, më të krahasueshëm, më konkurrues dhe më tërheqës për evropianët, si dhe për studentët dhe studiuesit nga kontinente të tjera.

Tre prioritetet e Procesit të Bolonjës janë: përfshirja e sistemit me tre cikle (d.m.th., diplomë/master/doktoraturë), sigurimi i cilësisë, si dhe njohja e kualifikimeve dhe periudhave të studimit. Takimi i Ministrave në Londër, në vitin 2007, miratoi krijimin e një Regjistri të Agjencive Evropiane të Sigurimit të Cilësisë.

Burimi: Faqja e internetit e Bashkimit Evropian për Procesin e Bolonjës, http://ec.europa.eu/education/policies/educ/bologna/bologna_en.html (vizituar në nëntor 2007).

Sistemi i sigurimit të cilësisë i çdo vendi kërkon vëmendje urgjente, me qëllim që të vendoset ekuilibri i duhur mes llogaridhënies dhe përmirësimit. Siç u parashtrua më sipër, vende të ndryshme kanë preferuar zgjidhje të ndryshme përsa i përket sigurimit të cilësisë, ku Shtetet e Bashkuara kanë fituar një përvojë të madhe në fushën e akreditimit, ndërsa vende, si Holanda e, deri në njëfarë mase, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar, vijnë nga një traditë të konsoliduar për inspektim nga organe të jashtme të sigurimit të cilësisë. Ndonëse nuk ka një model të vetëm të Bolonjës lidhur me sigurimin e cilësisë, vlen të vërehet se:

- vendet evropiane që kanë përvojë të konsiderueshme lidhur me sigurimin e cilësisë me anë të mekanizmave të jashtëm, siç janë Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda, kanë tendencë të përqendrohen më pak në nivel programi dhe më shumë në nivel institucioni. Vende të tjera evropiane, si Gjermania, e kanë gjithnjë e më të vështirë të mbajnë sisteme “të mirëmbajtjes së lartë”, të cilët nënkuptojnë kontroll të hollësishëm në nivel programi, ndërsa kohët e fundit kanë diskutuar për qasje që përqendrohen në nivel institucioni (ose “procesi”).²⁰
- Në përputhje me praktikën e mirë evropiane dhe ndërkombëtare, sigurimi i cilësisë po kombinon, gjithnjë e më shumë, qasjen e përshtatshmërisë *për* qëllimin me qasjen e përshtatshmërisë *së* qëllimit (shih diskutimin më lart të këtyre temave).

²⁰ Ky model është paraqitur nga Acquin, një agjenci gjermane akreditimi, që është e organizuar si rrjet i institucioneve të arsimit të lartë.

- Siç përmend më sipër, Komunikata e Berlinit thekson se institucionet e arsimit të lartë kanë përgjegjësi kryesore për cilësinë e arsimit që ofrojnë. “Modeli irlandez”, sipas të cilit sigurimi i cilësisë me anë të mekanizmave të jashtëm organizohet kryesisht nga vetë universitetet, ka tërhequr vëmendjen e shumë vendeve evropiane dhe më gjërë.
- Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG)²¹ ofrojnë kuadrin për agjencitë evropiane të sigurimit të cilësisë, të cilat po e zbatojnë atë, gjithnjë e më shumë, në veprimtaritë e tyre.

Prandaj, rekomandohet që, në Evropën Juglindore, sigurimi i cilësisë të përqendrohet më shumë te sigurimi i cilësisë me anë të mekanizmave të brendshëm, duke marrë parasysh praktikatat e mira që janë krijuar në Evropë dhe gjetkë. Siç u tha më sipër, krijimi i një sistemi të përgjithshëm të analizës nga homologët në shkallë rajoni, i cili të përqendrohet te praktikatat më të mira evropiane, mund të trajtohet në mënyrë serioze vetëm në nivel rajonal.

Roli i sektorit privat të arsimit të lartë

Nuk ekziston ndonjë recetë e caktuar lidhur me rolin e institucioneve private të arsimit të lartë, të cilat kanë kryer detyra të ndryshme në vende të ndryshme. Përsa i përket aksesit, në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, institucionet private kanë kontribuar për përmbushjen e kërkesës së ndrydhur për të kryer studime të larta, kërkesë kjo që ka qenë më e theksuar te nën-grupe të ndryshme të popullsisë (Slantcheva dhe Levy, 2007). Të gjitha vendet e Evropës Juglindore kanë nxjerrë ligje për arsimin e lartë, të cilat e trajtuan çështjen e arsimit privat menjëherë pasi u bënë të pavaruara. Sidoqoftë, këto vende, veçanërisht Bosnja dhe Kroacia, duhet të bëjnë kujdes që këto rregullore të mos e mbysin ofertën e institucioneve private, në një kohë kur asnjë institucion nuk arrin të pranojë regjistrimin e studentëve shtesë në shifra të konsiderueshme. Këtu është e dobishme përvoja e Lituanisë: institucioni i parë privat u njoh vetëm në vitin 1999, ndërkohë që 25 % e studentëve të Estonisë dhe 12 % e studentëve të Letonisë ishin regjistruar tashmë në institucione private (Slantcheva dhe Levy, 2007). Mungesa e institucioneve të sektorit privat e pengoi Lituaninë që ta zgjeronte, po aq shpejt sa edhe fqinjët e saj, numrin e studentëve të regjistruar në shkollat e larta. Ky vend ende ka mbetur pas dy

²¹ Shih: Shoqatën Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (2005).

vendeve të tjera balltike përsa i përket regjistrimeve në shkollat private dhe, ajo që është më e rëndësishme, numrit të përgjithshëm të studentëve të regjistruar në shkollat e larta.

Në Evropën Juglindore, sektori privat ndoshta do ta japë kontributin më të madh duke nxitur larminë e institucioneve të arsimit të lartë. Kjo larmi do të ndihmonte të sfidohej ideja se ekziston vetëm një lloj institucioni i arsimit të lartë, d.m.th., një institucion që ofron një gamë të plotë lëndësh dhe kombinon mësimdhënien me kërkimin shkencor. Në Evropën Qendrore dhe Lindore, si dhe Evropën Juglindore, institucionet private janë pothuajse gjithmonë më të vogla sesa institucionet publike (sigurisht, në nivel mesatar), rrallëherë ofrojnë diploma për punë kërkimore dhe, zakonisht, janë të përqendruara në një gamë më të ngushtë lëndësh dhe programesh. Sidoqoftë, institucionet private mund të modernizohen në një sërë mënyrash, për shembull, duke përfshirë modalitete të reja të aksesit dhe ofrimit të arsimit (p.sh.: të nxënit në distancë, kurse me kohë të pjesshme, mësimdhënie në orare që i përshtaten popullsisë që punon), si dhe përmirësime të programeve (d.m.th., hartimi i programeve mësimore që janë më afër kërkesave të tregut të punës, përfshirë, në një periudhë afatgjatë, tituj nën nivelin e diplomës). Fakti që janë krijuar me ose nëpërmjet një institucioni nga një vend tjetër, ka shërbyer si një mënyrë, me anë të së cilës institucionet private kanë arritur ta sigurojnë këtë lloj larmie.

Larmia e sektorit të arsimit të lartë kërkon që sistemi i sigurimit të cilësisë, në përgjithësi, dhe akreditimi dhe liçensimi, në veçanti, të mbështesin larminë institucionale. Kjo do të thotë se regjimet kombëtare apo rajonale të akreditimit duhet të përdorin qasjen e “përshtatshmërisë për qëllimin”, me anë të së cilës një institucion përcakton objektivat e tij dhe proceset e sigurimit të cilësisë synojnë ta ndihmojnë atë të arrijë objektivat e tij, si dhe të bëjë përmirësime të vazhdueshme. Sipas kësaj qasjeje, një institucion akreditohet nëse i përmbush (ose gjykohet se i ka kapacitetet për t’i përmbushur) objektivat që i ka vënë vetes. Sidoqoftë, në shumicën e vendeve, në bazë të kërkesave aktuale lidhur me liçensimin dhe akreditimin, supozohet se institucionet, në thelb, kanë të njëjtin grup objektivash dhe, për këtë arsye, kanë të njëjtën strukturë, përsa i përket numrit të lëndëve apo programeve që ofrojnë.²²

Përveç kësaj, qeveritë duhet të zgjidhin problemin e kontratave me institucionet publike që shumica e stafit akademik të institucioneve private të arsimit të lartë kanë

²² Pavarësisht nga fleksibiliteti që kërkohet në këtë aspekt, është e rëndësishme të vërehet se nga studentët e institucioneve private ende do të pritej që të plotësonin të njëjtat standarde përsa i përket rezultateve të të nxënit, si dhe studentët e institucioneve publike; siç përcaktohet nga ky prag, diploma në një lëndë të caktuar duhet të ketë të njëjtën vlerë, pavarësisht nga institucioni që e lëshon.

tashmë. Ky punësim i dyfishtë është i mirëpritur për pedagogë të veçantë, të cilët rrisin në mënyrë të ndjeshme pagat e tyre shtetërore, si dhe për institucionet private, të cilët arrijnë t'i rrisin të ardhurat e tyre me një nivel më të ulët llogaridhënieje, sesa ai që kërkohet për të ardhurat publike. Dypunësimi është pranuar nga qeveritë meqënëse ai ul presionin për burime publike shtesë, me qëllim që të bëhet e mundur rritja e numrit të studentëve të regjistruar. Sidoqoftë, këto marrëveshje, faktikisht, ofrojnë një subvencion publik për institucionet private, krijojnë konflikte të mundshme interesi dhe ndikojnë negativisht te cilësia e arsimit, sepse mësues të veçantë kanë detyrime dhe punëdhënës të shumëfishtë, si dhe një numër tepër të madh studentësh, kështu që rrjedhimisht nuk janë të aftë të ofrojnë një mësimdhënie cilësore. Një faktor i rëndësishëm që ka kontribuar për këtë situatë është se pedagogu i universitetit publik konsiderohet i punësuar me kohë të plotë (dhe merr një pagë të plotë) me shumë pak orë mësimi (katër orë në shumicën e vendeve), e, megjithatë, pagat vazhdojnë të mbeten të ulta.

Përmirësimi i kërkimit dhe zhvillimit

Në përpjekjet për përmirësimin e sistemeve të tyre të kërkimit dhe zhvillimit, vendet e Evropës Juglindore përballen me sfida të shumëfishta, por themelet për efektshmërinë e këtyre sistemeve, në një periudhë afatgjatë, duhen hedhur tani. Ndryshimet në vende të tilla, si Finlanda, Irlanda dhe Singapori, kërkuan disa dhjetra vjet dhe ka të ngjarë që e njëjta gjë të ndodhë me vendet e Evropës Juglindore.

Në një periudhë afatshkurtër, këto vende duhet ta vënë theksin më shumë te përshtatja e dijeve ekzistuese sesa te modernizimi dhe krijimi i dijeve të reja. Forcimi i lidhjeve mes universiteteve dhe ndërmarrjeve duhet të përbëjë prioritetin më të lartë. Kontributi më i madh që mund t'i japë një sektor kërkimi vendit, është që të ndihmojë kompanitë të përvetësojnë dhe të përshtasin ide dhe teknologji të reja nga vende të tjera. Që ky objektivi të arrihet, kërkohet që financimet private të rriten në mënyrë të ndjeshme, po ashtu edhe numri i punonjësve shkencorë të punësuar në sektorin privat. Përveç kësaj, duke u përqendruar te këto lidhesh sigurohet një mënyrë që fondet publike të orientohen në mënyrë më të efektshme.

Fatmirësisht, **shumë vende të botës kanë përvoja të suksesshme në zbatimin e partneriteteve publike-private për kërkimin dhe zhvillimin, të cilat shfaqen në një larmi formash.** Në këto partneritete, përfshihen përputhja e programeve të granteve, inkubatorët dhe parqet e shkencës/teknologjisë (Goldberg et al., 2007). Elementi më thelbësor është nevoja për

objektivitet në procesin e përzgjedhjes, ndërsa duhet të financohen vetëm propozimeve më të mira. Kjo lloj procedure parashikon shpërblim për transparencën e veprimeve të zyrtarëve publikë dhe përfshirjen e inspektorëve homologë nga jashtë vendit. Është e rëndësishme që risku të ndahet, ku sektori privat të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme (zakonisht, 50 % të koston së një projekti). Përbërja e organeve të jashtme drejtuese të institucioneve arsimore, përfshirja e kompanive private në hartimin e programeve mësimore dhe donacionet për kurset, krijimi i praktikave për studentët, si dhe të shërbyerit e punonjësve si mësues me kohë të pjesshme – të gjitha këto luajnë rolin e tyre për forcimin e lidhjeve mes institucioneve të arsimit të lartë dhe sektorit të biznesit.

Në një periudhë afatgjatë, vënia e theksit te përshtatja e dijeve ekzistuese kontribuon për përmirësimin e kërkimit bazë. Përvoja, njohuritë dhe paratë që fitohen në bashkëpunim me sektorin privat, kontribuojnë për krijimin e kapaciteteve të institucioneve dhe të njerëzve që bëjnë më shumë kërkime bazë. Gjithashtu, kjo jep një sinjal për qeveritë lidhur me fushat, në të cilat një vend i dhënë ka një avantazh të caktuar relativ, i cili mund të shfrytëzohet me investime të mëtejshme.

Që financimi publik t'i japë kërkimit bazë më pak prioritet, nevojiten qasje të reja lidhur me emërimin dhe ngritjen në detyrë të personelit akademik të universiteteve. Aktualisht, kriteri kryesor për ngritjen në detyrë, brendapërbrenda universitetit shtetëror, është publikimi i kërkimeve në periodikët akademikë. Zakonisht, nuk vlerësohet puna me ndërmarrjet apo cilësia e lartë e mësimdhënies. Në një periudhë afatmesme, në Evropën Juglindore, institucionet e arsimit të lartë mund të marrin në shqyrtim skema më fleksibël pagesash, gjë që do të bënte të mundur që ato t'u ofronin akademikëve stimuj për llojin e veprimtarive që ata duan të nxisin, në përputhje me misionet përkatëse të institucioneve.

Mbështetja për punonjësit shkencorë në moshë të re kërkon vëmendje të veçantë, qoftë sepse kjo siguron përmirësimin e prurjes së ekspertëve shumë të kualifikuar për kërkim dhe zhvillim, qoftë sepse punonjësit shkencorë në moshë të re mund të bëhen faktorë të ndryshimit. Kjo mbështetje mund të materializohet në forma të ndryshme. Së pari, në kuadrin e trainimit në kërkim — në përputhje me konsensusin më të gjerë evropian²³ — duhet të

²³ Shih “Konkluzionet dhe rekomandimet” e seminarit të Bolonjës për “Programet e doktoraturës për një shoqëri evropiane të dijes”, Salzburg, Austri, 3–5 shkurt 2005; gjenden në faqen e internetit të Qendrës së Informimit Akademik të Letonisë, http://www.aic.lv/ace/ace_disk/Bologna/Bol_semin/Salzburg/050203-05_Conclusions.pdf (vizituar në shkurt 2008).

pranohet fakti se kandidatët për titullin doktor janë edhe studiues, edhe punonjës shkencorë në fazë të hershme, fakte këto që duhet të pasqyrohen në statusin e tyre në institucion. Gjithashtu, programet e doktoraturës duhet të përmbushin nevojat e kandidatëve, të cilët dëshirojnë të ndjekin karrierën akademike, si dhe të atyre, të cilët synojnë ta vazhdojnë karrierën jashtë sektorit të arsimit të lartë. Me një fjalë, programet e doktoraturës duhet të pasqyrojnë një larmi objektivash, jo thjesht përgatitjen për mbajtjen e vendit të punës.

Është e nevojshme që punonjësve shkencorë në moshë të re, t'u ofrohen burime mbi bazë konkurrimi. Duke patur parasysh se moshë mesatare e personelit akademik dhe shkencor në universitetet e Evropës Juglindore është shumë e lartë, aktualisht, punonjësit shkencorë në moshë të re, nuk kanë akses te financimi (dhe te ndikimi politik që i shoqëron këto burime). Kjo situatë u jep atyre pak stimuj për të vazhduar karrierën si punonjës shkencorë. Financimi mbi bazë konkurrimi kontribuon që punonjësit shkencorë në moshë të re të luajnë një rol kyç në kërkimet e reja dhe të krijojnë të ardhura për institucionet e tyre (p.sh.: lidhur me novacionet, bashkëpunimin me industrinë dhe sigurimin e patentave). Mbështetje e veçantë duhet dhënë për të mundësuar lëvizjen e punonjësve shkencorë në moshë të re, brendapërbrenda rajonit të Evropës Juglindore dhe më gjërë, si dhe marrjen e masave garantuese dhe mbështetëse për ata që kthehen.

Duhet vënë në dukje se jo të gjithë akademikët e universiteteve të Evropës Juglindore do të jenë në gjendje të kryejnë kërkime origjinale, sidomos në institucione që kanë zgjedhur qëllimisht të përqendrohen te mësimdhënia dhe të nxënësve. Në këto institucione, sistemet e shpërblimit duhet ta pasqyrojnë këtë fakt, në vend që t'i kopjojnë sistemet e shpërblimit nga institucione të arsimit të lartë me misione të ndryshme. Punonjësit shkencorë të universiteteve dhe ata që punojnë në fushën e industrisë, duhet të përfitojnë nga ndërveprimi në rritje mes dy sektorëve, gjë që do të sillte përfitime si për institucionet e arsimit të lartë ashtu edhe për kompanitë. Në Evropën Juglindore, aktualisht, shumica e institucioneve nuk u kushton vëmendje të mjaftueshme këtyre çështjeve.

Ekziston një nevojë e qartë për bashkëpunim më të thelluar rajonal në fushën e kërkimit dhe zhvillimit. Në të ardhmen e parashikueshme, përse i përket kërkimit, vendet e Evropës Juglindore nuk do të arrijnë të shkëlqejnë në më shumë se disa fusha, për shkak të kushteve aktuale të infrastrukturës së kërkimeve dhe kufizimeve bazë nga dimensionet e tyre të vogël. Këto kufizime përbëjnë një sfidë të madhe për qeveritë, të cilat kërkojnë të identifikojnë

fushat që justifikojnë investimet dhe zhvillimin e mëtejshëm. Prandaj, qeveritë kanë dy mënyra sesi të shpërndajnë riskun e investimeve në fushën e kërkimit dhe zhvillimit Mënyra e parë është që, në këto vendime, të përfshihet sektori privat, meqenëse bizneset janë më të aftë sesa qeveritë për të përcaktuar fushat që i shtojnë vlerë kërkimit. Mënyra e dytë është që të krijohet bashkëpunimi mes vendeve dhe institucioneve, nëpërmjet të cilit investimet koordinohen dhe burimet — d.m.th., njerëzit, pajisjet dhe idetë — shkëmbehen.

Në vendet e Evropës Juglindore, një pjesë e mirë e kërkimeve, veçanërisht në nivelin bazë, është kryer nga institucione të specializuara. Institutet kërkimore dhe akademitë kanë një identitet të veçantë ligjor dhe marrëveshje për financim nga universitetet e rajonit, por, gjatë viteve nëntëdhjetë, financimi i tyre u ul ndjeshëm, ose, në disa raste, mungoi krejtësisht. Ka gjasa që marrja në shqyrtim e rolit të këtyre organeve, përfshirë disa prej tyre, nëse ka, duhet të funksionojë veçmas nga universitetet, dhe të jetë një objektiv i rëndësishëm për një periudhë afatmesme. Në mënyrë më të përgjithshme, duhet të merren në shqyrtim marrëdhëniet mes mësimdhënies dhe kërkimit. Ky raport, sidoqoftë, nuk bën përpjekje për t'i trajtuar këto çështje për shkak të objektivit së tij mjaft të gjerë, si dhe faktit se do të ishte e nevojshme që të kapërceheshin pengesa shumë të vështira politike.

III. Zbatimi i ndryshimit nëpërmjet bashkëpunimit rajonal

Realizimi i programit të reformës së parashtruar më sipër kërkon kohë dhe burime të konsiderueshme shtesë. Këto kërkesa mbështesin një strategji të qartë për sa i përket zbatimit dhe ndarjes së shpenzimeve nëpërmjet bashkëpunimit rajonal, dy çështje këto që diskutohen në këtë pjesë.

Ky studim nuk bën përpjekje të përlogarisë kostot e reformave të ndryshme që diskutohen; sidoqoftë, është e qartë se burimet që nevojiten, do të ishin të konsiderueshme. Ndërmarrja e disa veprimtarive, nëpërmjet bashkëpunimit rajonal, është një mënyrë për t'i bërë këto kosto më të përballueshme. Për më tepër, bashkëpunimi rajonal është i nevojshëm për një reformë efektive dhe të qëndrueshme, sepse disa çështje nuk mund të trajtohen në mënyrë të suksesshme në nivel kombëtar — disa struktura dhe procedura duhet të krijohen përtej kufijve kombëtarë, në mënyrë që vendet ta kapërcejnë bllokadën e reformës, me të cilën përballen aktualisht.

Bashkëpunimi rajonal mes vendeve të Evropës Juglindore mund të ketë dy forma bazë. Në formën e parë, veprimtaritë kanë kryesisht karakter kombëtar, por, meqënëse të gjitha vendet e rajonit përballen me të njëjtat çështje, ato mund të trajtohen bashkarisht në mënyrë të koordinuar. Forma e dytë e bashkëpunimit përbëhet nga veprimtari që *kërkojnë* një qasje rajonale në mënyrë që të jenë të efektshme.

Ndër veprimtaritë e bashkërenduara rajonale mund të përfshihen:

- përmirësimi i sigurimit të cilësisë së universiteteve me anë të mekanizmave të jashtëm;
- përmirësimi i sigurimit të cilësisë i universiteteve me anë të mekanizmave të brendshëm;
- mbështetja e krijimit të sistemeve të grumbullimit të të dhënave dhe treguesve të cilësisë së universitetit, të njohura në shkallë ndërkombëtare; dhe,
- mbështetja e veçantë për punonjësit shkencorë në moshë të re.

Ndër veprimtaritë e integruara rajonale mund të përfshihen:

- një qendër rajonale për sigurimin e cilësisë me anë të mekanizmave të jashtëm;

- qendra rajonale të cilësisë së lartë, veçanërisht për kërkime shkencore dhe arsimimin universitar. Këto qendra mund të jenë në dy forma: (a) institucione të ndryshme të vendeve të ndryshme, të cilat specializohen në lëndë të ndryshme, por të cilat krijojnë profile të qarta për të nxitur lëvizjen e studentëve dhe punonjësve shkencorë; dhe (b) institucione të vendeve të ndryshme, të cilat punojnë bashkarisht për të përmirësuar kërkimin shkencor (dhe mësimdhënien) në një fushë të dhënë;
- programe të përbashkëta diplomash;
- një program grantesh për të mbështetur veprimtaritë e përbashkëta për përmirësimin e mësimdhënies dhe të të nxënit;
- një qendër burimore rajonale e arsimit të lartë, e cila do t'i mbështeste institucionet në përpjekjet e tyre për zbatimin e Procesit të Bolonjës; do të shpërndante informacionin për praktikatat e mira evropiane dhe ndërkombëtare në mësimdhënie dhe në përvetësimin e njohurive; do të mundësonte bashkëpunimin dhe lëvizjen në shkallë ndërkombëtare, dhe do të krijonte kapacitete për ministritë e arsimit të lartë dhe shkencës; dhe,
- financimi dhe nxitja e marrëveshjeve për lëvizjen mes vendeve.

Përveç rajonit të Evropës Juglindore, për të mundësuar bashkëpunimin rajonal duhet të ndërmerren veprime në tre nivele të tjera:

- *Nivel evropian:* konteksti dhe kuadri, në të cilin vendet reformojnë sistemet e tyre të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor, përcaktohen gjithnjë e më shumë nga Bashkimi Evropian. Të gjitha vendet e rajonit i janë bashkuar Procesit të Bolonjës. Bashkimi Evropian ka burime të konsiderueshme financimi, si për të zbatuar objektivat e Bolonjës (p.sh.: TEMPUS), ashtu edhe për të përmirësuar kërkimin shkencor dhe zhvillimin (d.m.th., Programet Kuadër).
- *Nivel kombëtar:* qeveritë duhet të plotësojnë kërkesat e Bashkimit Evropian duke ndryshuar legjislacionin, duke ofruar financimin e duhur dhe duke eliminuar pengesat për lëvizjen e punonjësve shkencorë dhe akademikëve. Gjithashtu, ato duhet të sigurojnë bazën për universitetet e integruara dhe sistemet e përshtatshme të sigurimit të cilësisë me anë të mekanizmave të jashtëm.
- *Nivel institucional:* përvoja evropiane dhe ndërkombëtare ka treguar që e ardhmja e arsimit të lartë janë universitetet e fuqishme që janë autonome (në mënyrë që të mund të

kryejnë detyrat e tyre publike), por që japin njëkohësisht llogari përpara shoqërisë. Administrimi i këtyre institucioneve duhet të jetë fleksibël dhe efikas, meqënëse ata mbajnë përgjegjësinë kryesore për sigurimin e cilësisë dhe zbatimin e Procesit të Bolonjës.

Në vendet e Ballkanit, tashmë ekzistojnë disa nisma rajonale për arsimin, si dhe kërkimin shkencor dhe zhvillimin. Këto nisma kanë një larmi strukturash organizative dhe mandatesh, si dhe përfaqësim nga vendet jashtë rajonit, përfshirë:

- organe me një pjesëmarrje të gjerë të vendeve, nivel të lartë pjesëmarrjeje dhe një mandat të gjerë që shkon përtej arsimit dhe kërkimit shkencor, siç janë Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (ish Pakti i Stabilitetit) dhe Nisma e Evropës Qendrore;
- organe me një pjesëmarrje më të ngushtë të vendeve dhe përfaqësim teknik nga ministritë e arsimit, siç është Nisma për Reformën në Arsim në Evropën Juglindore dhe Grupi i Punës për Ndërtimin e Kapitalit Njerëzor, në kuadrin e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal; dhe
- organe ekspertesh me anëtarë që paguajnë kuota, siç është Shoqata e Universiteteve Evropiane.

Banka Botërore synon ta përdorë këtë raport analitik si bazë për diskutime me vendet e Ballkanit. Gjatë diskutimeve të tilla, do të kërkohet të bëhet verifikimi i fakteve dhe i argumenteve që u paraqitën këtu, do të përcaktohen mënyra për t'u ofruar vendeve asistencë për të përshpejtuar reformën në arsimin e lartë, kërkimin shkencor dhe zhvillimin.

Shtojca 1. Treguesit e axhendës së Lisbonës

| | | Shqipëria | Bosnjë- Hercegovina | Bullgaria | Kroacia | Maqedonia | Mali i Zi | Rumania | Serbia (vitet 2000, 2001 përfshijnë Malin e Zi) | Silovenia | Bashkimi Evropian 15 | Bashkimi Evropian 27 |
|------------------|---|-----------|------------------------|-----------|---------|-----------|-----------|---------|--|-----------|-------------------------|-------------------------|
| Objektivi | Investimi i 2% të PBB-së në arsimin e lartë | | | | | | | | | | | |
| Treguesi | Shpenzimet private dhe publike në institucionet e arsimit të lartë dhe në administratë, si përqindje e PBB-së | 0.50% | n/a | 1.31 % | 0.83 % | 0.44 % | n/a | 0.78% | n/a | 1.30% | 1.10 % | 1.33% |
| Viti | | 2003 | 2003 | 2003 | 2003 | 2003 | 2003 | 2002 | 2003 | 2002 | 2003 | 2004 |

Burimi: Banka e të dhënave të Institutit të Statistikave të UNESCO-s, shkurt 2008; Komisioni i Komiteteve Evropiane ("Ecuria drejt objektivave të Lisbonës në arsim dhe trainim," tregues dhe standarde, 2007) për 27 vendet e BE-së.

| Objektivi | Shpenzimi i 3% të PBB-së për kërkimin shkencor dhe zhvillimin deri në vitin 2010 | | | | | | | | | | | |
|------------------|--|-----------|------------|--------|--------|--------|------------|-------|----------|-------|--------|-----------|
| Treguesi | Shpenzimet e përgjithshme bruto të brendshme për kërkim shkencor dhe zhvillim, si përqindje e PBB-së | 0.18% (*) | 0.05 % (*) | 0.51 % | 1.14 % | 0.26 % | 0.24 % (*) | 0.40% | 0.5% (*) | 1.61% | 1.98% | 1.93% (*) |
| Viti | | 2003 | 2006 | 2004 | 2003 | 2002 | 2006 | 2004 | 2004 | 2004 | 2001 * | 2001 |

Burimi: Banka Botërore (2005), Seksioni i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (2004), Banka e të dhënave të Institutit të Shkencës dhe Teknologjisë së UNESCO-s.

* *Burimi:* Raportet e vendeve për Shkencën dhe Teknologjinë, BE.

| | | Shqipëria | Bosnjë- Hercegovina | Bullgaria | Kroacia | Maqedonia | Mali i Zi | Rumania | Serbia (vitet 2000, 2001 përfshijnë Malin e Zi) | Sllovenia | Bashkimi Evropian 15 | Bashkimi Evropian 27 |
|--|--|-----------|------------------------|-----------|---------|-----------|-----------|---------|---|-----------|-------------------------|-------------------------|
|--|--|-----------|------------------------|-----------|---------|-----------|-----------|---------|---|-----------|-------------------------|-------------------------|

| Objektivi | Rritja e lëvizjes mes vendeve e studentëve të arsimit të lartë | | | | | | | | | | | |
|-----------|--|------|-----|------|------|------|-----|------|-----------|------|-----|-----|
| Treguesi | Niveli i lëvizjes drejt vendit (%) | 0.9 | n/a | 3.6 | 2.3 | 0.6 | n/a | 2.6 | n/a | 2.3 | n/a | n/a |
| Treguesi | Niveli i lëvizjes nga jashtë vendit (%) | 26.3 | n/a | 10.5 | 8.3 | 14.8 | n/a | 1.5 | 5.81 (**) | 1.0 | n/a | n/a |
| Viti | | 2004 | | 2005 | 2003 | 2005 | | 2005 | 2001 | 2005 | | |

Burimi: Banka e të dhënave të Institutit të Statistikave të UNESCO-s, shkurt 2008.

| Objektivi | Rritja të paktën 15% e numrit të të diplomuarve në matematikë, shkencë dhe teknologji deri në vitin 2010 (krahasuar me vitin 2000) | | | | | | | | | | | |
|-----------|---|-----------|-----|-----------|-----------|-----------|-----|-----------|-------------|-----------|-----|-----|
| Treguesi | Ndryshim i numrit të të diplomuarve nga arsimit i lartë në inxhinieri, prodhim, ndërtim dhe shkencë, si përqindje e numrit të përgjithshëm të të diplomuarve (për qind) | -0.56% | n/a | 3.82 % | 5.76 % | 7.88 % | n/a | -2.60% | -0.07% (**) | 4.89 % | n/a | n/a |
| Viti | | 2000-2003 | | 2000-2005 | 2000-2003 | 2000-2005 | | 2000-2005 | 2000-2001 | 1999-2005 | | |

Burimi: Banka Botërore, përlogaritjet janë bazuara te banka e të dhënave të SIMA-S, Shkurt 2008.

** Serbia dhe Mali i Zi.

Referenca

- Adamović, Mirjana dhe Silva Mežnarić. 2003. "Researching Potential Migrants: The 'Brain Drain' of Young Scientists from Croatia." Në gjuhën kroate. *Sociological Review [of Croatia]* 24, nr. 3–4: 143–60.
- Barr, Nicholas, ed. 2005. *Labor Markets and Social Policy in Central and Eastern Europe: The Accession and Beyond*. Washington, D.C: Banka Botërore.
- Betcherman, Gordon, Martin Godrey, Shweta Jain, Arvo Kuddo, Toby Linden, and Keiko Miwa. 2007. "The Labor Market and Education and Training in the Western Balkans: A Policy Note." Banka Botërore, Uashington, D.C. Dorëshkrimin e disponojnë autorët.
- KE (Komisioni Evropian). 2006. *European Innovation Progress Report 2006: Trendchart*. Luksembourg: Zyra për Publikimet Zyrtare të Komuniteteve Evropiane.
- . 2007. "Progress Towards the Lisbon Objectives in Education and Training: Indicators and Benchmarks 2007." BE, Bruksel, http://ec.europa.eu/education/policies/2010/doc/progress06/report_en.pdf. (vizituar në shkurt 2008).
- Shoqata e Universiteteve Evropiane, 2003. "Institutional Review of Ss. Cyril and Methodius University in Skopje." Programi Vlerësimit Institucional. EUA, Bruksel.
- . 2007. "Trends V." EUA, Bruksel.
- Shoqata Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. 2005. *Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area*. Helsinki: Shoqata Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, http://www.bologna-bergen2005.no/Docs/00-Main_doc/050221_ENQA_report.pdf. (vizituar në shkurt 2008).
- Qendra Evropiane për Arsimin e Lartë. 2005. "Statistical Information on Higher Education in Central and Eastern Europe 2004-2005." Qendra Evropiane për Arsimin e Lartë, http://www.cepes.ro/information_services/statistics.htm (vizituar në nëntor 2007).
- Gesellschaft zur Foerderung der Forschung. 2006. *Research and Development in South Eastern Europe*. Vienë: Neuer Wissenschaftlicher Verlag GmbH.
- Goldberg, Itzhak, Manuel Trajtenberg, Adam Jaffe, Thomas Muller, Julie Sunderland, dhe Enrique Blanco Armas. 2007. "Transforming Russian Universities into World-Class Universities: Briefing Note." Banka Botërore, Uashington, D.C.

- Grubb, Norton. 2003. "The Roles of Tertiary Colleges and Institutes: Trade-offs in Restructuring Postsecondary Education." Banka Botërore, Uashington, D.C.
- Kwiek, Marek. 2007a. "The European Integration of Higher Education and the Role of Private Higher Education." Slantcheva and Levy, *Private Higher Education*, 119–34.
- Kwiek, Marek. 2007b. "The Legal Integration of Universities and its Impact on University Management in South Eastern Europe." Raport i përgatitur për Bankën Botërore.
- Mertaugh, Michael dhe Eric Hanushek. 2005. "Education and Training." In Barr, *Labor Markets and Social Policy*, 207–242.
- OECD (Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik). 2007. *Education at a Glance 2007*. Paris: OECD.
- Pachuashvili, Marie 2007. "Legitimacy Sources and Private Growth." Slancheva and Levy, *Private Higher Education*, 75–93.
- Patrinos, Harry Anthony, Cris Ridao-Cano dhe Chris Sakellariou. 2006. "Estimating the Returns to Education: Accounting for Heterogeneity in Ability." World Bank Policy Research Working Paper, no. 4040. Banka Botërore, Uashington, D.C.
- Radosevic, Slavo. 2007. "Research and Development and Competitiveness in South Eastern Europe: Asset or Liability for EU Integration?" Economics Working Paper, no. 75. Qendra për Studimin e Ndryshimit Ekonomik dhe Social në Evropë (CSESCE), Kolegji Universitar, Londër.
- Republika e Kroacisë. Ministria e Shkencës, Arsimit dhe Sporteve. 2007. *OECD Thematic Review of Tertiary Education: Country Background Report for Croatia*. Zagreb: Ministria e Shkencës, Arsimit dhe Sporteve.
- Rutkowski, Jan, dhe Stefano Scarpetta 2005. *Enhancing Job Opportunities in Eastern Europe and the Former Soviet Union*. Uashington, D.C: Banka Botërore.
- Salmi, Jamil, dhe Arthur M. Hauptman. 2006. *Innovations in Tertiary Education Financing: A Comparative Evaluation of Allocation Mechanisms*. Education Working Paper Series, no. 4. Banka Botërore, Uashington, D.C.
- Slantcheva, Snejana. 2007. "Legitimizing the Difference: Private Higher Education Institutions in Central and Eastern Europe." Slantcheva and Levy, *Private Higher Education*, 55–76.
- Slantcheva, Snejana, dhe Daniel C. Levy, eds. 2007. *Private Higher Education in Post-Communist Europe: In Search of Legitimacy*. Nju Jork dhe Bazingstouk, Inglënd: Palgrave Macmillan.

UNESCO Instituti për Statistikat. N.d. Science and Technology Database (vizituar gjatë periudhës qershor 2007–shkurt 2008).

Seksioni i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë. 2004. *World Population Prospects*. Nju Jork: PNUD.

Uvalic, Milica. N.d. “Science, Technology, and Economic Development in South Eastern Europe.” Science Policy Series, no. 1. UNESCO, Venecia.

Banka Botërore. 1994. *Higher Education: The Lessons of Experience*. Uashington, DC: Banka Botërore.

———. 2002. *Constructing Knowledge Societies: New Challenges for Tertiary Education*. Uashington, D.C: Banka Botërore.

———. 2003. “Project Appraisal Document for the Bosnia Education Restructuring Project.” Banka Botërore, Washington, D.C.

———. 2005. *World Development Indicators*. CD-ROM. Uashington, DC.

———. 2006. “Public Financial Support for Commercial Innovation: Europe and Central Asia Knowledge Economy Study, Part I.” Banka Botërore, Uashington, D.C.

———. 2007. *From Red to Gray: The “Third Transition” of Aging Populations in Eastern Europe and the Former Soviet Union*. Uashington, D.C.: Banka Botërore.

———. 2007a. “Bulgaria: Accelerating Bulgaria’s Convergence: The Challenge of Raising Productivity.” Report no. 38570. Njësia e Reduktimit të Varfërisë dhe Menaxhimit Ekonomik, Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore, Banka Botërore, Uashington, D.C.

———. 2007b. “Croatia Living Standards Assessment.” Report 37992-HR. Njësia e Reduktimit të Varfërisë dhe Menaxhimit Ekonomik, Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore, Banka Botërore, Uashington, DC.

WEF (World Economic Forum). 2007. *The Global Competitiveness Report 2007–2008*. Gjenevë: WEF.

Yusuf, Shahid, and Kaoru Nabeshima, eds. 2007. *How Universities Promote Economic Growth*. Uashington D.C.: Banka Botërore.

Ziderman, Adrian. 2005. *Policy Options for Student Loans Schemes*. Paris: Instituti Ndërkombëtar për Planifikimin Arsimor, UNESCO.

Ziegele, Frank. 2007. "Funding Higher Education in Montenegro: Challenges—Models—Next Steps." Raport i përgatitur për Bankën Botërore.



THE WORLD BANK
1818 H Street, NW
Washington, DC 20433

www.worldbank.org/education

Ky dokument shqyrton sfidat që përballen nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe Sllovenia më qëllim që të kenë një fuqi pune me një grup të konsiderueshëm njerëzish me kualifikim të arsimit të lartë. Megjithatë, këta njerëz do të duhen për t'ju përgjigjur kërkesës në rritje për fuqi punëtore me aftësi të lartë dhe për të mbështetur rritjen ekonomike. Rënia e shpejtë në numrin e grupeve të të rinjve krijon probleme të nivelit të ulët të diplomimeve dhe shpesh nivele të ulëta regjistrimi, rritje të ngadaltë në institucionet private, dhe një gamë problemesh serioze me cilësinë. Gjithashtu, sistemet e kërkimit dhe zhvillimit në EJL japin pak kontribut për konkurueshmërisë së vendeve të tyre përkatëse nëpërmjet novacioneve. Dokumenti propozon një gamë zgjidhjesh politike. Këto përfshijnë ristrukturimin ligjor të universiteteve, dhënien e përparësisë së lartë zbatimit të duhur të Proçesit të Bolonjës si një mënyrë për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të mësuarit, reformën e sistemit të financimit për t'i bërë sistemet e arsimit të lartë më reaguese dhe efiçente, dhe gjetjen e rolin të përshtatshëm për institucionet e sektorit privat. Në fushën e kërkimit dhe zhvillimit, duhet të ketë një theks më të madh mbi përshtatjen e njohurive ekzistuese në vend të novacionit dhe krijimit të njohurive të reja të cilat mund të arrihen dhe mbështeten vetëm në pak fusha të përzgjedhura. Realizimi i axhëndës së reformës të përmendur më sipër do të kërkojë kohë dhe, në mënyrë të veçantë, burime të konsiderueshme shtesë. Kjo mbështet idenë e një strategjie të mirë-hartuar zbatimi dhe për një ndarje të shpenzimeve nëpërmjet bashkëpunimit rajonal. Banka Botërore ka si synim të përdorë këtë dokument analitik si bazë për diskutimet me vendet e Ballkanit Perëndimor.

The findings, interpretations and conclusions expressed in this paper are entirely those of the authors and should not be attributed in any manner to the World Bank, its affiliated organizations or to the members of its board of executive directors or the countries they represent.

Copies of this publications may be obtained in hard copy through the Education Advisory Service (eservice@worldbank.org) and electronically through the World Bank Education website (www.worldbank.org/education).